

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

2024-2030



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

PËRMBAJTJA

1. HYRJA

2. KONTEKSTI STRATEGJIK

- Qëllimi i dokumentit strategjik
- Kuadri ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit
- Deklarata e vizionit

3. QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË SNKK 2024-2030

- **Qëllimi i parë i Politikës: Parandalimi i korrupsionit**
- Objektivi Specifik 1.1: Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit
- Objektivi Specifik 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes
- Objektivi Specifik 1.3: Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)
- Objektivi Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore
- Objektivi Specifik 1.5: Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik
- Objektivi Specifik 1.6: Forcimi i kornizës së sinjalizuesëve për zbulimin e hershëm të korrupsionit
- Objektivi Specifik 1.7: Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike
- Objektivi Specifik 1.8: Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsionit
- Objektivi Specifik 1.9: Promovimi i integritetit në sektorin privat
- **Qëllimi i dytë i Politikës: Ndëshkimi i korrupsionit**
- Objektivi Specifik 2.1: Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korrupsionit
- Objektivi Specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit
- Objektivi Specifik 2.3: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimin ekonomik dhe pastrimit të parave
- **Qëllimi i tretë i Politikës: Ndërgjegjësimi dhe edukimi kundër korrupsionit**
- Objektivi Specifik 3.1: Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin
- Objektivi Specifik 3.2: Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit
- Objektivi Specifik 3.3: Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit
- Objektivi Specifik 3.4: Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm

4. MASAT PRIORITARE PËR ZBATIMIN E SNKK 2024 - 2030

- Përcaktimi i masave prioritare të qeverisë në kuadër të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030

5. ZBATIMI, LLOGARIDHËNIA DHE KOORDINIMI

- Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit

6. PLANI I VEPRIMIT DHE VLERËSIMET FINANCIARE

- Kostimi i zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 sipas tre Qëllimeve të Politikës

HYRJE

Prej vitit 2015, Shqipëria ka miratuar dhe zbaton një kuadër strategjik në luftën kundër korrupsionit, me qëllim koordinimin e të gjithë përpjekjeve të të gjitha institucioneve përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit, si institucione të Qeverisë, institucione të pavarura të veshura me kompetenca të luftës kundër korrupsionit si dhe institucione ligjzbatuese dhe të gjyqësorit. Nga ana e saj, Qeveria Shqiptare ka udhëhequr përpjekjet në luftën kundër korrupsionit paralelisht në disa drejtime, me fokus të veçantë shtrirjen kapilare të digjitalizimit të shërbimeve publike, ngritjen e sistemeve funksionale të ankesave, si dhe forcimin e arkitekturës institucionale në luftën kundër korrupsionit, për të avancuar politikën antikorrupsion dhe për të vëzhguar e më pas vepruar mbi tendencat e shpërfaqjes së korrupsionit në të gjithë aparatit qeverisës. Paralelisht, të gjithë institucionet publike përgjegjëse në drejtim të parandalimit të korrupsionit, ndërgjegjësimit si dhe ndëshkimit, janë zhvilluar në drejtim të zbatimit të politikave antikorrupsion, por edhe në drejtim të rritjes së efektivitetit të hetimit dhe gjyqësorit të rasteve të korrupsionit.

Përgjatë këtij harku kohor, Shqipëria vendosi gurin e themelit në luftën kundër korrupsionit përmes miratimit dhe zbatimit të reformës në drejtësi, si një nga reformat më efektive në luftën kundër korrupsionit, si përmes zbatimit të sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ashtu edhe përmes ngritjes së strukturave të posaçme për hetimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, konkretisht Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, si dhe Gjykatën e Shkallës së Parë dhe atë të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Rezultatet e punës së këtyre institucioneve, janë vlerësuar pozitivisht edhe nga partnerët ndërkombëtarë, që monitorojnë progresin e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, përfshirë këtu Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të të gjitha arritjeve në luftën kundër korrupsionit, si dhe adresimin e drejtpërdrejtë të të gjitha detyrimeve që burojnë nga procesi i negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, forcimi dhe thellimi i kuadrit strategjik me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së reformave dhe vazhdimësinë e ndërhyrjeve për të reduktuar progresivisht incidencën e korrupsionit, merr rëndësi thelbësore. Lufta ndaj korrupsionit mbetet një nga sfidat kryesore të vendit, dhe për këtë arsye lind si domosdoshmëri forcimi dhe mirëkoordinimi i të gjithë përpjekjeve institucionale për të adresuar në mënyrë sistematike çdo problematikë që cenon integritetin e performancës institucionale.

Në nivel qeveritar, prioritizimi i politikave antikorrupsion është ngritur në tjetër nivel në vitin 2024 me krijimin e pozicionit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, i cili njëkohësisht ushtron edhe kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, për të sinergjizuar punën e institucioneve të ekzekutivit në raport me politikën antikorrupsion të Qeverisë dhe zbatuar të gjitha zotimet, në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies.

Në këtë kontekst, Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, përfaqëson një dokument me angazhime konkrete të të gjithë institucioneve që ushtrojnë kompetenca në drejtim të parandalimit, ndëshkimit dhe ndërgjegjësimit ndaj luftës kundër korrupsionit, përfshirë këtu, institucione publike në nivel qendror dhe vendor, institucione të pavarura si dhe institucione ligjzbatuese dhe ato që i përkasin gjyqësorit.

Ngritur mbi këtë kuadër institucional, Strategjia paraqet një qasje të re me ndërhyrje sistemike në fusha vulnerabël ndaj korrupsionit, forcimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor në luftën kundër korrupsionit, shtrirjen e masave të parandalimit të korrupsionit në pushtetin vendor, promovimin e integritetit në biznes, konsolidimin e mëtejshëm të kuadrit institucional përgjegjës për hetimin dhe gjykimin e korrupsionit, si dhe promovimin e integritetit në sektorin privat, ashtu edhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e të rinjve mbi ligjshmërinë dhe integritetin. Ky kuadër i ri strategjik garanton përputhje të plotë me angazhimet e ndërmarra nga institucionet shqiptare në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe adreson në mënyrë koherente gjetjet e Komisionit Evropian në Raportin e Shqyrtimit Analitik për Grupkapitullin e Parë "Themeloret" mbi hapat e nevojshëm për të përmirësuar performancën e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit, si një ndër fushat kyçe të avancimit të shtetit të së drejtës dhe vendosjen e gurëve kilometrikë drejt aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

PARANDALIM. NDËSHKIM. NDËRGJEGJËSIM

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, përbëhet nga një strukturë të bazuar në tre qëllime politikash: Parandalim (I) - Ndëshkim (II) - Ndërgjegjësim (III).

Politika e parë, Parandalimi (I) synon konsolidimin dhe zhvillimin e instrumenteve dhe mekanizmave të parandalimit të korrupsionit, duke promovuar integritetin, transparencën dhe etikën në të gjitha nivelet e qeverisjes, si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Parandalimi i korrupsionit ul nevojën për ndëshkim penal dhe ka një impakt më të gjerë në promovimin e besimit të publikut dhe qeverisjes së mirë të zyrtarëve publikë. Parandalimi do të fokusohet tek sektorët vulnerabël ndaj korrupsionit dhe promovimin e punës së zyrtarëve publikë mbi baza integriteti dhe llogaridhënieje. Në kuadër të parandalimit synohet gjithashtu, promovimi i mëtejshëm i përdorimit të ligjshëm të fondeve publike, transparenca e financave të partive politike, normimi i instrumentave të lobimit, etj. Një vëmendje e veçantë do i kushtohet gjithashtu edhe nxitjes së sektorit privat me qëllim promovimin e integritetit në fushën e biznesit.

Nëpërmjet **politikës së dytë, Ndëshkimit (II)** strategjia do të synojë konsolidimin e hetimit dhe ndjekjes penale të korrupsionit. Institucionet ligjzbatuese dhe organet e drejtësisë do të intensifikojnë përdorimin e mjeteve hetimore efektive, të dedikuara për të luftuar korrupsionin, burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare në kuadër të këtij funksioni, si dhe të rrisin bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër krimit transnacional. Në këtë qëllim politikash synohet dhe plotësimi i kuadrit rregullator, strukturave operacionale dhe ndërveprimi mes strukturave përgjegjëse për hetimin penal të korrupsionit.

Nëpërmjet **politikës së tretë, Ndërgjegjësimit (III)** strategjia synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit kundër korrupsionit, përmes forcimit të edukimit mbi integritetin në sistemin arsimor parauniversitar, niveleve arsimore, si dhe nëpërmjet forcimit të edukimit të sektorit publik, me qëllim garantimin e një sektori publik përgjegjës dhe llogaridhënës përpara shoqërisë.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, është një dokument politikash në nivel kombëtar që nxit bashkëpunimin e organeve të pushtetit ekzekutiv, autoriteteve të pavarura kushtetuese, institucioneve jo qeveritare dhe sektorit privat.


Qeveria Shqiptare dhe të gjitha institucionet e tjera bashkëpërgjegjëse në luftën kundër korrupsionit, me këtë strategji mbeten të zotuar për të ndërmarrë të gjitha ndërhyrjet e nevojshme në nivel ligjor, institucional dhe operacional, si kundërpërgjigje për të adresuar nevojat që diktohen në kuadër të luftës kundër korrupsionit.

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
ADB	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
AMP	Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
AK	Autoritetet Kontraktore
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMSHC	Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
ATP	Agjencia e Trajtimit të Pronës
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPAK	Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
GJKKO	Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
INSTAT	Instituti i Statistikave
IQ	Inspektorati Qendror
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKKK	Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
KMSHC	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
KSHZ	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
MAPA	Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MF	Ministria e Financave
MSHMP	Ministër Shteti për Marrdhëniet me Parlamentin
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MSHPV	Ministër Shteti për Pushtetin Vendor
MSHSKB	Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PSH	Policia e Shtetit
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SHM	Shkolla e Magjistraturës
ZRA	Zyra e Rikuperimit të Aseteve

PJESA I

KONTEKSTI STRATEGJIK



1. Qëllimi i dokumentit strategjik

Qëllimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, është të orientojë politikat kryesore në drejtim të luftës kundër korrupsionit të udhëhequra nga të gjitha institucionet përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, mbështetet nga një Plan Veprimi me masa specifike zbatimi, me afate kohore të përcaktuara e përgjegjësi institucionale të parashikuara dhe garanton një mekanizëm monitorimi të këtyre masave, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe koordinimit ndërinstytucional.

Gjatë hartimit të këtij dokumenti strategjik, u vlerësuan tri mundësi:

(i) Mundësia 0: Opsioni i status quo-së do të ishte që në parim të linte situatën të qëndronte siç ishte në fund të vitit 2023 dhe të mos vazhdohej me procesin e reformave antikorrupsion. Përfundimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 do të rezultonte në ndërprerjen e matjes së 18 objektivave strategjike, masave dhe aktiviteteve përbërëse, si dhe do të bënte të pamundur adresimin e mëtejshëm të objektivave që paraqesin risk të lartë, sikurse do të ndalonte vijim e reformave në këtë fushë, duke penguar dhe procesin e avancimit të negociatave të aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

(ii) Mundësia 1: Zgjatja e afatit të strategjisë aktuale dhe planit të saj të veprimit, do të ishte një alternativë e mundshme, me përfundimin e afatit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023. Ky opsion do të kursente kostot e lidhura me hartimin e një strategjie të re, por në të njëjtën kohë do të pengonte rifreskimin e vizionit për luftën kundër korrupsionit, në këtë fazë të zhvillimit të vendit, në kohën kur Shqipëria ka hapur Grupkapitullin e parë të negociatave "Themeloret", duke e bërë më të vështirë adresimin e natyrës gjithnjë e më dinamike të fenomenit të korrupsionit, si dhe përgatitjen e një përgjigjeje koherente dhe të qartë ligjore e institucionale për sfidat aktuale.

(iii) Mundësia 2: Miratimi i një strategjie të re, me afat kohor 2024-2030, përqendron përpjekjet në rikonceptimin e objektivave specifike, duke marrë parasysh fazën aktuale të zbatimit të SNKK 2025-2023 dhe nevojën për të përfshirë fusha dhe sektorë të rinj në vëmendje si dhe adresimin e të gjitha detyrimeve që burojnë nga procesi i negociatave me BE-në. Strategjia e re do të ofronte një programim strategjik për fusha dhe sektorë që paraqesin prirje dhe rrezik ndaj korrupsionit, duke siguruar bashkërendimin e aktorëve të ndryshëm brenda dhe jashtë sektorit publik. Kjo do të realizohej përmes një linje të përbashkët veprimi dhe angazhimi, e cila do të promovonte një qasje të koordinuar dhe të integruar në luftën kundër korrupsionit. Kjo qasje do të përfshinte përfundimin e reformave ligjore dhe institucionale, duke vijuar me një program intensiv investimesh në institucionet që ofrojnë shërbime. Njëkohësisht, do të sigurohej përmirësimi i kapaciteteve koordinuese, menaxhuese dhe të komunikimit, për t'u përshtatur me nevojat e sektorëve deri në përfundimin e efekteve juridike të strategjisë në vitin 2030.

Pas vlerësimit të mundësive të përmendura më lart, dhe duke marrë parasysh fazën aktuale të reformës antikorrupsion, **mundësia e dytë (2)** konsiderohet si më e përshtatshme për zbatimin e saj.

Në këtë kuadër, procesi i hartimit të strategjisë kaloi në tre faza:

Faza I: Kjo fazë, përqendrohet në përgatitjen e terrenit për zhvillimin e një strategjie të re dhe përshtatjen e saj me zhvillimet aktuale dhe sfidat e identifikuara përgjatë procesit të negociatave veçanërisht në Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit për Grup-kapitullin e Parë të korrikut 2023 dhe detyrimet e ndërmarra në kuadër të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës. Për të analizuar ndryshimet në kontekstin e luftës kundër korrupsionit, kjo fazë u fokusua në analizimin e situatës aktuale të korrupsionit në vend, identifikimin dhe analizimin e sektorëve dhe fushave që janë më të ndjeshme ndaj rrezikut të korrupsionit dhe që kërkojnë ndërhyrje. Gjithashtu, bazuar në analizën e situatës, u përcaktuan objektivat specifike të strategjisë për periudhën 2024-2030. Këto objektiva përshkruajnë qartë synimet në luftën kundër korrupsionit në përmbushje të plotë me vizionin e Shqipërisë 2030.

Faza II: Pas konsolidimit të bazës së orientimit strategjik të dokumentit, hapi i ardhshëm përfshinte hartimin e konceptit të strategjisë me të gjithë elementët përbërës të saj. Kjo fazë ka për qëllim zbatimin e reformave ligjore dhe institucionale për të adresuar sfidat dhe rreziqet e korrupsionit. I gjithë procesi realizohet përmes identifikimit dhe hartimit të reformave ligjore të nevojshme për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në sektorët dhe fushat e ndryshme. Për të garantuar zbatimin dhe monitorimin efektiv të këtyre reformave ligjore dhe institucionale, do të jetë e nevojshme ndërtimi i mekanizmave dhe strukturave të përshtatshme, që do të sigurojnë funksionimin e duhur dhe efektiv të këtyre ndryshimeve.

Faza III: Në fazën përfundimtare, synohet forcimi i kapaciteteve të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë për të menaxhuar me sukses efektivitetin e strategjisë dhe për të adresuar sfidat e korrupsionit. Përmirësimi i kapaciteteve realizohet përmes zhvillimit profesional të burimeve njerëzore të angazhuara në luftën kundër korrupsionit, duke kontribuar në thellimin dhe zgjerimin e reformave. Ndryshimet e ndërmarra do të funksionojnë me efikasitet, duke mundësuar që zyrtarët publikë përgjegjës të jenë të aftë të monitorojnë dhe përmirësojnë vazhdimisht proceset e punës në funksion të objektivave të kësaj strategjie.

Monitorimi dhe vlerësimi i progresit përmes krijimit të mekanizmave për arritjen e rezultateve të pritshme u është dhënë rëndësi thelbësore në këtë fazë. Strategjia përcakton objektiva specifike, programe, masa dhe aktivitete që synojnë arritjen e qëllimeve dhe rezultateve të prekshme dhe realiste, duke detajuar qartë detyrimet për çdo institucion përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kjo qasje siguron një zbatim efektiv të aktiviteteve antikorrupsion, të cilat përfshijnë një numër të madh institucioneve publike në nivel ekzekutiv, vendor, kushtetues dhe gjyqësor, dhe kërkojnë bashkëpunim të ngushtë ndërmjet tyre për t'u realizuar në mënyrë të suksesshme.

Qëllimet e politikave



2. Kuadri Ligjor dhe Institucional në Luftën Kundër Korrupsionit

Shqipëria ka përmirësuar gradualisht kornizën e saj ligjore dhe institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Përgjatë viteve, Shqipëria ka ratifikuar instrumente ndërkombëtare të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit si: Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,¹ Konventat e të Drejtës Civile dhe asaj Penale të Këshillit të Evropës për Korrupsionin,² Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy Protokollat e saj shtesë, Marrëveshjen midis Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për Bashkëpunim Strategjik dhe Operacional.

Kuadri ligjor i brendshëm kundër korrupsionit përmban një seri aktesh që nisin që me Kushtetutën, legjislacionin procedural administrativ dhe penal, ligjet specifike të organizimit dhe funksionimit të institucioneve përgjegjëse në drejtim të luftës kundër korrupsionit si dhe kuadrin rregullator të instrumenteve kundër korrupsionit.

Në referencë të parashikimeve të Kodi Penal, korrupsioni është një vepër e dënueshme penalisht.³ Megjithatë, përtej këtij përcaktimi, legjislacioni shqiptar parashikon një sërë sjelljesh të cilat bazohen në kërkesën për integritet në qeverisje, transparencë institucionale

¹ Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), Miratuar 2003-ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 9492, datë 13.03.2006.

² Konventa Penale për Korrupsionin dhe protokollit shtesë (1999), Këshilli i Evropës -ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 8778, datë 26.4.2001; Konventa Civile për Korrupsionin e Këshillit të Evropës (1999) - ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 8635, datë 6.7.2000.

³ Neni 244, 245, 259 dhe 260 i Kodit Penal të Republikës të Shqipërisë.

llogaridhënie publike si parakushte për parandalimin e korrupsionit. Më konkretisht, legjislacioni shqiptar parashikon detyrime ligjore për institucionet publike në drejtim të transparencës së punës së administratës publike, ⁴ parandalimit të konfliktit të interesit, ⁵ kontrollit mbi deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publikë, ⁶ sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesëve ⁷ dhe etikën në qeverisje. ⁸

Nga pikëpamja institucionale, në kuadër të reformës në drejtësi u vendos një gur kilometrik në avancimin e luftës kundër korrupsionit përmes krijimit të Prokurorisë së Posaçme për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Prej rreth 4 vitesh këto institucione po krijojnë në mënyrë progresive një historik solid (track record) të hetimit, gjyqimit dhe dënimit të veprave penale të korrupsionit, si dhe sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprës penale të korrupsionit. Përgjatë kësaj periudhe kohe, këto institucione kanë dëshmuar dilijencë në hetimin dhe gjykimin e rasteve të zyrtarëve të lartë të dyshuar për korrupsion, duke shembur kështu mitin e pandëshkueshmërisë në abuzimin e ushtrimit të funksionit publik.

Në nivel qeveritar, përpjekjet për të luftuar korrupsionin drejtohen nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, që programon të gjitha përpjekjet qeveritare për parandalimin, ndërgjegjësimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në administratën publike.

Shqipëria është cilësuar nga OECD Sigma, si një ndër shtetet në vijën e parë për plotësimin e standardeve të qeverisjes elektronike si dhe nga Komisioni Evropian për reduktimin e korrupsionit dhe informalitetit përmes ofrimit të shërbimeve digjitale. Kalimi nga 14 shërbime online në 2013 fillimisht vetëm për 50 mijë përdorues, në 1247 shërbime tërësisht online në 2024 për 3,1 milion përdorues të regjistruar, nga vulat dhe firmat në letër në ato elektronike është dëshmi e qartë e shkallës së penetrimit të digjitalizimit në ndërveprimin me qytetarët dhe bizneset, duke shmangur ndërveprimin fizik në sportel. Përgjatë të gjithë spektrit të shërbimeve publike, si për qytetarët dhe për bizneset, revolucionarizimi i ofrimit të shërbimeve të lidhura me kujdesin shëndetësor (sistemi i referimit, recetat elektronike, regjistri i pacientëve, rekrutimi i infermierëve), shërbimet e sistemit arsimor (rekrutimi i mësuesve, aplikimi në shkolla institucione të arsimit të lartë, regjistrat digjitale), shërbimet e transportit rrugor (licenca dhe leje), ato të regjistrimit të bizneseve dhe fiskalizimit, kanë zvogëluar ndjeshëm hapësirat korruptive.

Falë digjitalizimit të shërbimeve dhe rritjes së numrit të sistemeve digjitale, institucionet publike janë të pajisur shumë më tepër se më parë me mundësitë që të gjurmojmë inefiçencat dhe vonesat në kthim përgjigjesh të cilat shpesh mund të bëhen shkak për korrupsion. Ndaj dhe përfitimi nga digjitalizimi në këto vitet e fundit ka qenë i dyfishtë, si në drejtim të eliminimit tërësor të korrupsionit në sportele, por edhe rritjes së llogaridhënies së brendshme dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së institucioneve shërbimofruese.

4 Ligji nr. 119, datë 18.9.2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar dhe Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

5 Ligji nr. 9367, datë 07.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar.

6 Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar.

7 Ligji nr. 60, datë 2.6.2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesëve", i ndryshuar.

8 Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike". Këtu mund të përmendim edhe akte nënligjore dhe vendime që rregullojnë rregullat e etikës për deputetët e Kuvendit, apo dhe për strukturat e policisë dhe subjektet e sistemit gjyqësor, gjyqtarë dhe prokurorë.

Paralelisht, 10 vitet e fundit kanë shënjuar një revolucion të të gjithë arkitekturës së funksionimit të prokurimit publik në Shqipëri. Shkalla e lartë e përafrimit me legjisllacionin e BE-së dhe përdorimi i sistemeve elektronike, open data në prokurimin publik, janë vlerësuar si zhvillime pozitive në raportin vjetor dhe Raportin Screening të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Në raportin e fundit të SIGMA fusha e prokurimit publik ka vlerësim maksimal në 3 prej treguesve të lidhur me cilësinë e kuadrit ligjor, kapacitetit qendror institucional dhe administrativ për të zbatuar dhe monitoruar politikat e prokurimit publik në mënyrë efektive dhe zhvillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesave.⁹

Një ndër treguesit kryesor antikorrupsion në proceset e prokurimit, përkatësisht numri i procedurave me negociim pa shpallje, në vitin 2013 ka qenë në masën 33.2% të totalit të procedurave të prokurimit ndërsa dekadën e fundit kjo shifër ka pësuar rënie drastike duke arritur vetëm në masën 2.9% në vitin 2023, arritje kjo e vlerësuar gjithashtu në raportet vjetore të Komisionit Evropian. Një tregues tjetër i rritjes së performancës së sistemit të prokurimit elektronik është dhe kursimi i arritur si diferencë midis fondit limit dhe fondit të shpallur fitues, i cili ishte në masën 6.6% në 2013, ndërsa në 2023 rezulton të jetë 15%, duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në optimizimin e përdorimit të fondeve publike.

Megjithatë, pavarësisht arritjeve të përmendura më sipër, ka ende një sërë problematikash në drejtim të efektivitetit të luftës kundër korrupsionit, si në drejtim të parandalimit, hetimit dhe ndëshkimit si dhe ndërgjegjësimin lidhur me fenomenin e korrupsionit dhe natyrën gërryese të tij në shoqëri.

2.1. Lidhja me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 (SKZHI III)

Sigurimi i një kornize ligjore dhe institucionale të fortë është thelbësor për suksesin e Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit.

Nëpërmjet reformave ligjore dhe institucionale, synohet parandalimi, ndëshkimi i praktikave abuzive dhe ndërgjegjësimi për dëmet që korrupsioni shkakton në shoqëri. Përmirësimi i efikasitetit të mekanizmave përmes rolit të shtuar koordinues të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit si dhe zbatimit të monitorimit të instrumenteve antikorrupsion duhet adresuar sipas parashikimeve të SKZHI.

Në seksionin “Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë” të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030, “Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit”, mes të tjerash, parashikohen çështjet kryesore që lidhen drejtpërdrejtë me reformat kundër korrupsionit, të cilave u duhet kushtuar një vëmendje e veçantë:

- Forcimi i integritetit dhe parandalimi i korrupsionit në administratën publike dhe të gjithë segmenteve shtetërore. Fokus i veçantë i dedikohet institucioneve që ofrojnë shërbime publike për qytetarët, si prokurimet publike, shërbimet elektronike, trajtimin e rasteve dhe denoncimeve për korrupsion;
- Forcimi i zbatimit të ligjit dhe shtetit të së drejtës, ndëshkimi i akteve korruptive në të cilat zyrtarët publikë mund të përfshihen dhe garantimi i integritetit të organeve shtetërore;
- Përfshirja e publikut në luftën kundër korrupsionit, duke e informuar mbi veprimtarinë shtetërore kundër korrupsionit dhe nxitur atë për të përdorur në mënyra aktive kanalet për ta denoncuar;
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe edukimi i të rinjve për t'u angazhuar në mënyrë produktive në luftën kundër korrupsionit.

⁹ <https://www.sigmaxweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>, fq. 155-177.

2.1.1. Qëllimet e politikës

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, parashikon 3 Qëllime Politikash:

Qëllimi Politik 1: Parandalimi i korrupsionit - Forcimi i mekanizmave dhe kapaciteteve ligjore dhe institucionale për parandalimin e korrupsionit dhe forcimi i integritetit në administratën publike, me fokus në sektorët me risk të lartë korrupsioni.

Qëllimi Politik 2: Ndëshkimi i korrupsionit - Rritja e performancës së të gjitha strukturave përgjegjëse për ndjekjen, hetimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit.

Qëllimi Politik 3: Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit - Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe edukimi i publikut për t'u angazhuar në mënyrë proaktive në luftën kundër korrupsionit.

2.2. Lidhja e SNKK 2024-2030 me strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2024-2030 harmonizohet me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e strategjive të mëposhtme kombëtare:

- Strategjia Kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025;
- Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë 2021-2025;
- Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030;
- Strategjia Ndërsektorale Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022-2026";
- Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026;
- Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030 dhe Plani i Veprimit.

2.3. Lidhja me PKIE-në & Acquis e BE-së

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 është gjithashtu e lidhur ngushtësisht me PKIE-në & acquis e BE-së. Konkretisht, Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore, është një kapitull thelbësor në procesin e negociatave për anëtarësim. Ky kapitull mbulon tri fusha të rëndësishme: (i) sistemin gjyqësor, (ii) politikat kundër korrupsionit dhe (iii) të drejtat themelore.

Raportet e fundit të Progresit nga Komisioni Evropian për Shqipërinë për vitet 2021-2023 vlerësojnë se Shqipëria ka arritur njëfarë niveli përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit dhe njohin përpjekjet e vazhdueshme të vendit në avancimin e kësaj agjende. Krahas vijimit me zbatimin e Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, theksohet se procesi i rivlerësimit kalimtar në sistemin gjyqësor ka sjellë rezultate në luftën kundër korrupsionit. Raportet njohin përparimin e arritur veçanërisht përmes vazhdimin të zbatimit të reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi, duke evidentuar ngritjen dhe vendosjen në funksion të plotë të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimeve, si dhe ngritjen dhe funksionimin e plotë të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO). Në këtë linjë, nënvizohet

¹⁰ E rikonfirmuar me Strategjinë Ndërsektorale e Drejtësisë, 2024-2030, miratuar në dhjetor 2024, në përputhje me prioritetet strategjike dhe angazhimet e Qeverisë shqiptare në Udhërrëfyesin Shteti i së Drejtës.

veçanërisht kontributi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në përmirësimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale në çështjet e korrupsionit.

Raporti i Progresit i publikuar në vitin 2023 evidenton rritjen e numrit të dënimeve për korrupsion në nivelet e larta, si një prioritet i rëndësishëm në luftën kundër kulturës së pandëshkueshmërisë. Raporti ka dhënë vlerësimet e tij edhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit (si strukturë përbërëse e Ministrisë e Drejtësisë në periudhën referencë të raportit), kapaciteti i së cilës duhet të përforcohet më tej. Vëmendje e shtuar kërkohet për sektorët më të prekshëm (vulnerabël) nga korrupsioni dhe për të cilët kërkohet të kryhen vlerësime të risqeve dhe masa për ndërhyrje të dedikuara.

Këto rekomandime nënvizohen paralelisht edhe në Raportin e korrikut 2023 të Shqyrtimit Analitik për Shqipërinë për Grup-kapitullin I "Themeloret". Mes hapave të rëndësishme që duhen ndërmarrë për të garantuar efikasitetin e përpjekjeve parandaluese antikorrupsion, theksohen nevoja për rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit mes autoriteteve me kompetenca parandaluese dhe atyre ndëshkuese, nevoja për përmirësimin e kapaciteteve të ILDKPKI-së për verifikimin e deklaratave të pasurisë dhe interesave private, si dhe domosdoshmëria e forcimit të zbatimit efikas të kuadrit ligjor për promovimin e sinjalizimit të praktikave korruptive dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Raporti rekomandon gjithashtu marrjen e masave të shtuara për rritjen e efikasitetit të procesit të konsultimit publik dhe forcimin e mëtejshëm të kuadrit të prokurimit publik.

Për sa i përket qasjes ndëshkuese, Raporti thekson nevojën për rritjen e kapaciteteve dhe konsolidimin e funksionimit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) përfshirë strukturën e saj të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), duke siguruar mjetet e nevojshme të hetimit dhe një sistem modern të menaxhimit të çështjeve. Gjithashtu, theksohet forcimi i bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe zgjerimi i hetimeve financiare dhe konfiskimit të aseteve. Komisioni inkurajon veçanërisht krijimin e një historiku solid të hetimit dhe ndëshkimit të korrupsionit në nivele të larta dhe rritjen e ekspertizës për sekuestrimin e aseteve brenda dhe jashtë vendit.

Në përputhje me sa më sipër, Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 garanton linjëzimin e masave dhe afateve përkatëse të parashikuara me zotimet konkrete të ndërmarra nga autoritetet e përfshira në luftën kundër korrupsionit në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar me Vendim Nr.736, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave. Udhërrëfyesi adreson gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të Shqyrtimit Analitik për Grup-kapitullin I, duke parashikuar mes angazhimeve kyçe zbatimin e qëndrueshëm dhe efikas të kuadrit strategjik dhe ligjor për korrupsionin në përputhje të plotë me standardet e BE-së. Me qëllim uljen e incidencës së korrupsionit, autoritetet janë angazhuar të trajtojnë vazhdimisht rreziqet e korrupsionit në sektorët më vulnerabël, si dhe të masin efektivitetin e këtyre masave përmes objektivave të Treguesve të Performancës së Strategjisë së re Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 në baza vjetore.

Udhërrëfyesi parashikon paralelisht zbatimin e vazhdueshëm të objektivave ndërgjegjësuere të Strategjisë, duke u fokusuar veçanërisht në ndërgjegjësimin brenda institucioneve të administratës publike, si dhe pjesëmarrjen e shtuar të shoqërisë civile në procesin e politikbërjes dhe monitorimit në drejtim të luftës kundër korrupsionit. Autoritetet zotohen në garantimin e qëndrueshmërisë dhe transparencës në procesin e deklarimit të pasurisë, si dhe të konfliktit të interesit. Njëherësh, në aspektin e bashkëpunimit ndërinstytucional, parashikohet përmirësimi i bashkëpunimit midis agjencive shtetërore dhe shërbimeve të prokurorisë, me qëllim rritjen e koherencës në luftën kundër korrupsionit. Prioritet mbetet adresimi i

rekomandimeve të GRECO-s për Shqipërinë dhe konsolidimi i qëndrueshëm i agjencive ligjzbatuese të angazhuara në luftën kundër korrupsionit deri në vitin 2027.

Në qasjen ndëshkuese, angazhimet antikorrupsion të Udhërrëfyesit synojnë rritjen e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese, veçanërisht të Prokurorisë së Posaçme – SPAK-ut, për të kryer më mirë hetime proaktive dhe ndërkufitare të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, si dhe përmirësimin e historikut të hetimeve proaktive dhe ndjekjes penale, duke përfshirë sektorët më të prirur ndaj korrupsionit dhe garantimin e dënimeve të formës së prerë për korrupsionin. Gjithashtu, autoritetet synojnë përmirësimin e performancës për ndjekjen sistematike e konfiskimit të produkteve nga veprat penale të korrupsionit deri në vitin 2030, duke ngushtuar hendekun me pasuritë e sekuestruara, mes të tjerash përmes aftësisimit dhe trajnimit intensiv të zyrtarëve të përfshirë në të gjithë ciklin e identifikimit, gjurmimit, ngrirjes, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve, duke synuar procese gjithnjë e më efektive deri në vitin 2030.

Në linjë me sa më sipër, Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030, si dokumenti strategjik ombrellë në luftën kundër korrupsionit, reflekton angazhimet për një zbatim të qëndrueshëm dhe efikas të masave antikorrupsion në përputhje me standardet evropiane. Strategjia garanton përputhje të plotë me angazhimet e ndërmarra nga institucionet shqiptare në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe adreson në mënyrë koherente gjetjet e Komisionit Evropian mbi hapat e nevojshëm për të përmirësuar performancën e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit.

2.4. Lidhja me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), në mënyrë specifike objektivi nr. 16 promovon nxitjen e shoqërive gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, ofrimin e qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 synon të forcojë strukturat institucionale, përgjegjshmërinë dhe transparencën e institucioneve. Në të tri qëllimet e politikës programohen masa për ndërhyrje në këto fusha, për të promovuar konsolidimin e një sistemi funksional në luftën kundër korrupsionit. Strategjia detajohet në 16 objektive specifike që janë në korrelacion të drejtpërdrejtë me objektivin nr. 16 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

2.5. Lidhja e SNKK 2024-2030 me marrëveshje të tjera ndërkombëtare

Rëndësia e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit theksohet nga përfshirja e këtyre çështjeve në instrumente të ndryshme ligjore ndërkombëtare, duke pasqyruar angazhimin global për të adresuar këtë fenomen. Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh të dedikuara në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkatësisht si më poshtë:

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) është një traktat ndërkombëtar shumëpalësh kundër korrupsionit i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në tetor 2003 dhe ka hyrë në fuqi në dhjetor 2005. Ajo u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë më 13 mars 2006 me Ligjin nr. 9492 dhe u dekretua nga Presidenti me dekretin nr. 4820, datë 28.03.2006.

Nëpërmjet Ligjit nr. 8635, datë 6.7.2000 Shqipëria ka ratifikuar Konventën Civile të Këshillit të Evropës "Për korrupsionin", më pas me Ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001 u ratifikua

Konventa Penale për Korrupsionin të Këshillit të Evropës dhe njëkohësisht edhe Protokollin Shtesë të Konventës Penale për Korrupsionin me Ligjin nr. 9245, datë 24.6.2004. Të tre këto instrumente ndërkombëtare synojnë të parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin, duke e vënë theksin në rëndësinë e luftës kundër korrupsionit për të mbrojtur shtetin e së drejtës dhe qeverisjen demokratike.

Në vijim, më datë 12 qershor 2006 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit reflekton drejtimet kryesore dhe zotimet e ndërmarra me qëllim garantimin e progresit drejt procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Gjatë zbatimit të MSA-së, Republika e Shqipërisë duhet të provojë jo vetëm se ndan të njëjtat vlera me Bashkimin Evropian por edhe se disponon kapacitetet e nevojshme për vënien në jetë të detyrimeve të parashikuara në Marrëveshje. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e ngarkon Shqipërinë me detyrime edhe në drejtim të luftës kundër korrupsionit. Konkretisht, neni 4 i kësaj marrëveshje, neni 78 dhe 85 parashikojnë detyrimin e shtetit shqiptar për t'u angazhuar në mënyrë proaktive dhe bashkëpunuar me vendet e rajonit dhe BE-në në luftën kundër korrupsionit, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat, duke kontribuar kështu në përmirësimin dhe forcimin e arkitekturës institucionale dhe sundimin e shtetit të së drejtës.

Të gjithë angazhimet e sipërpërmendura i ngarkojnë institucionet publike shqiptare me përgjegjësi dhe dëshmojnë përpjekjet në më shumë se një dekadë në përmbushjen e zotimeve të ndërmarra në luftën kundër korrupsionit, si dhe për zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin ndaj luftës kundër korrupsionit.

2.6. Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i reformës gjatë periudhës 2015-2023

Në vitin 2015, Qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2020, zbatimi i së cilës u shty deri në vitin 2023. Përgjatë këtyre viteve, SNKK, ka qenë dokumenti kryesor që përcaktonte politikën kundër korrupsionit në Shqipëri dhe ka orientuar veprimet kundër korrupsionit në nivel kombëtar.

Vizioni i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023, synonte të siguronte *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*, dhe duke e mundësuar këtë me parashikimin e rezultateve dhe angazhimeve të planit të veprimit, për 18 objektivë specifikë. Strategjia ishte e strukturuar në tre qëllime madhore politikash: parandalimi (A), ndëshkimi (B) dhe ndërgjegjësimi (C).

Një numër i rëndësishëm reformash të planifikuara në këtë strategji ka dhënë rezultate konkrete, si më poshtë:

- Rritja e transparencës së autoriteteve publike në nivel qendror dhe vendor: 337 autoritete publike kanë zbatuar programe transparence dhe garantojnë informimin e publikut përmes koordinatoreve të së drejtës së informimit, ndërsa 222 prej tyre kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe ankesave online.
- Harmonizim i legjislacionit të brendshëm për prokurimin publik sipas standardeve të BE dhe ngritjen e strukturave dhe kapaciteteve të operatorëve: Agjencia e Prokurimit Publik ka mbajtur rregullisht elementët e ndryshuar në regjistrin e parashikimeve nën masën 20% ¹⁰

¹⁰ Viti 2021: në masën 16.1%; Viti 2022: në masën 13.61; Viti 2023: në masën 14%.

si dhe procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe ndryshimet e kontratave nën masën 10%.¹¹

- Deklarimi i pasurive të zyrtarëve: Funkzionimi i sistemit plotësisht online, duke garantuar kështu transparencë në procesin e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve. Vënia në funksionim të plotë të këtij sistemi nga ILDKPKI ka marrë vlerësimin “zbatuar plotësisht” edhe në roundin V të vlerësimit në GRECO, që në fazën e parë të tij, në dhjetor 2022.
- Krijimi dhe zbatimi i kuadrit të parë ligjor për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve,¹² si dhe ngritja dhe funksionimi i plotë i strukturave përgjegjëse në sektorët publik dhe privat.
- Digjitalizimi i 95% të shërbimeve publike nëpërmjet platformës kombëtare të shërbimeve e-Albania, duke eliminuar plotësisht faktorin njerëzor në ofrimin e shërbimeve, duke ofruar 1247 e-shërbime online për të gjithë qytetarët në të gjithë sektorët.
- Hartimi dhe miratimi i Planeve të Integritetit si instrumente të parandalimit të korrupsionit në ministri, institucione të varësisë së ministrive si dhe në 24 njësi të vetëqeverisjes vendore.
- Përmirësimi i inspektimeve financiare për abuzimin me fondet publike për 90% të sinjalizimeve të marra, të cilat plotësojnë kriteret ligjore.
- Mbledhja, përpunimi dhe harmonizimi i statistikave të konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar për periudha të ndërmjetme, gjashtëmujore, dhe vjetore duke integruar të dhëna nga të gjitha organet e zbatimit të ligjit, si Policia e Shtetit, prokuroritë dhe gjykatat.

Në kuadër të qasjes ndëshkimore dhe zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023, disa nga arritjet më të rëndësishme përfshijnë:

- Forcimi i kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit përfshirë këtu SPAK dhe njësinë hetimore të tij BKH, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, dhe policinë për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin dhe krimin ekonomik.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar përmes rrjeteve ndërkombëtare të bashkëpunimit në kuadër të EUROJUST, Interpol, Europol, Rrjeti CARIN, etj. dhe garantimi i aksesit të drejtpërdrejtë të Policisë së Shtetit, prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe SPAK në 21 baza të dhënash shtetërore.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.
- Ngritja e Drejtorisë së Përgjithshme e Antikorrupsionit, me mekanizmin e saj të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion ka administruar në total 1342 ankesa, në vetëm 2 vitet e para të veprimtarisë që nga ngritja e saj prej vitit 2021, duke propozuar 532 masa disiplinore për shkeljet e evidentuara, 263 rekomandime për ndryshime të natyrës ligjore/ rregullatore/ institucionale, si dhe ka referuar 48 kallëzime penale.

Përmes zbatimit të SNKK 2015-2023, disa nga arritjet kryesore në drejtim të ndërgjegjësimit janë:

- Janë zhvilluar një sërë veprimtarish për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet e korrupsionit dhe ushtrimin e funksioneve publike bazuar në parime të integritetit, duke përfshirë grupe të ndryshme interesi.
- Janë hartuar dhe publikuar plane vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit, të fokusuar në

¹¹ Viti 2021: në masën 3% (procedura pa shpallje paraprake) dhe në masën 1% (ndryshimet e kontratave), Viti 2022: në masën 3.36% (procedura pa shpallje paraprake) dhe në masën 4.8% (ndryshimet e kontratave), Viti 2023: në masën 3% (procedura pa shpallje paraprake) dhe në masën 6.6% (ndryshimet e kontratave).

¹² Ligji nr.60, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar.

publik mbi përpjekjet për të luftuar korrupsionin, angazhimin e publikut dhe komunikimin e vazhdueshëm të rezultateve.

- Janë zhvilluar, në baza vjetore, Javët e Integritetit në bashkëpunim me një sërë partnerësh ndërkombëtarë, me qëllim informimin mbi rëndësinë e integritetit dhe nxitjen e debatit publik mbi këtë fenomen.
- Janë zhvilluar takime dhe forume bashkëpunimi me organizata biznesi, përfshirë dhoma dhe shoqata të biznesit, me fokus të veçantë në denoncimin e rasteve të korrupsionit.
- Janë përgatitur dhe shpërndarë botime për publikun që ofrojnë informacion mbi mekanizmat e denoncimit në luftën kundër korrupsionit, si për shembull: Guida Antikorrupsion dhe Fjalori për Antikorrupsionin. Gjithashtu, janë realizuar video informuese mbi mekanizmin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, duke synuar edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut për mënyrat e denoncimit të rasteve të korrupsionit dhe për përfshirjen në luftën kundër këtij fenomeni.
- Janë hartuar dhe shpërndarë, në baza mujore, instrumente të informimit elektronik si e-buletini “Antikorrupsion”, me qëllim informimin e rregullt të publikut mbi progresin, aktivitetet dhe nismat në luftën kundër korrupsionit.
- Janë zhvilluar programe antikorrupsion nga Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, të titulluara **“Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut”**, duke përfshirë projekte të propozuara nga organizatat e shoqërisë civile në fusha të ndryshme si prokurimet, arsimit, shëndetësia, zbatimi i ligjit dhe e drejta e informimit.

Gjithashtu, përgjatë viteve të zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023 është ngritur dhe zhvilluar mekanizmi i monitorimit, një drejtori e dedikuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit, një strukturë e dedikuar teknike që mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat e zbatimit të strategjisë dhe të planeve të veprimit. Ky mekanizëm ka për qëllim zbatimin me efektivitet të masave të parashikuara në strategji, të publikuara dhe të aksesueshme për të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit që dëshirojnë të kenë një panoramë të plotë të përpjekjeve sistematike dhe performancës së përgjithshme të institucioneve përgjegjëse në përmbushjen e objektivave që kjo strategji parashikonte.

Në vijim, në vitin 2018¹³, u krijua Komiteti Koordinativ për zbatimin e strategjisë ndërsektorale kundër korrupsionit, në cilësinë e organit që diskuton dhe miraton raportet e monitorimit dhe adreson ndërhyrjet për veprime. Për Strategjinë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2025-2023 janë prodhuar 9 raporte progresi monitorimi, mbi baza vjetore dhe semestrale, mbështetur tek një metodologji konkrete me indikatorë performance të përcaktuar. Të gjitha raportet e monitorimit janë publikuar dhe janë lehtësisht të aksesueshme për qytetarët.

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023 forcoi gjithashtu bashkëpunimin midis autoriteteve publike, duke bashkërenduar urat e komunikimit midis institucioneve qendrore dhe atyre kushtetuese, që janë përgjegjëse për zbatimin e politikave në drejtim të luftës kundër korrupsionit.

Zbatimi dhe monitorimi i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023 konsolidoi bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile që janë aktive në politikat dhe sektorin e luftës kundër korrupsionit, duke i përfshirë ato rregullisht në takimet e Komitetit

¹³ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.241, datë 20.4.2028, “Për miratimin e planit të veprimit 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të pasaportë së indikatorëve, krijimin, funksionimin dhe detyrat e Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektorale kundër Korrupsionit, 2015-2020, dhe Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.516, datë 1.7.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2015-2020, dhe miratimin e planit të veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2015-2023 e të pasaportës së indikatorëve”.

Koordinativ. Kjo qasje kontribuoi në një shkëmbim më të thelluar të ideve dhe përforsimin e veprimeve të përbashkëta në luftën kundër korrupsionit.

Niveli i zbatimit të planit të masave të veprimit ka shënuar vlera të qëndrueshme zbatimi në masën 70% të strategjisë.

Megjithatë, pavarësisht arritjeve dhe zhvillimeve në drejtim të luftës kundër korrupsionit, zbatimi i SNKK 2015-2023 evidentoi edhe nevojën për adresimin e një sërë sfidash që u konstatuan në drejtim të rritjes së efektivitetit të luftës kundër korrupsionit, në këtë fazë të zhvillimit të vendit.

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023, evidentoi nevojën për të siguruar harmonizim të mëtijshëm të kuadrit ligjor me acquis të BE-së për antikorrupsionin, kapacitete institucionale kompetente dhe burime financiare për të parandaluar, hetuar e gjykuar korrupsionin në mënyrë efektive, në përputhje me kontekstin e brendshëm të vendit.

Harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional do të duhet të shtrihet edhe në ato mekanizma të luftës kundër korrupsionit si: zbatimi i një qasjeje sektorale në luftën kundër korrupsionit, përmirësimi i strukturave të sinjalizimit dhe mbrojtja e sinjalizuesve, ngritja e kuadrit rregullator për lobimin si instrument kundër korrupsionit apo masat ligjore kundër ryshfetit të zyrtarëve publikë të huaj. Njëherësh, është e nevojshme të ndërmerren nisma të përbashkëta me sektorin privat me qëllim ngritjen dhe promovimin e sistemeve të integritetit si dhe koordinimin e masave në raste të incidencës së korrupsionit.

Trajnimet periodike dhe të vazhdueshme për stafet antikorrupsion janë të një rëndësie thelbësore, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës institucionale.

Strategjia ka nxjerrë gjithashtu në pah nevojën për një koordinim më efektiv me të gjithë aktorët e përfshirë, që nga fazat e hershme të zbatimit. Ky koordinim synon të rrisë efektivitetin dhe të sigurojë vazhdimësinë e progresit në zbatimin e masave të parashikuara, duke garantuar një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse në luftën kundër korrupsionit.

2.7. Vazhdimi i strategjisë me një fokus më të qartë

Në funksion të vazhdimësisë së ndërhyrjes strategjike, fushat e veprimeve prioritare u identifikuan bazuar në një analizë të thelluar cilësore dhe sasiore të treguesve të performancës, shtrirjes, formave dhe çështjeve të tjera që lidhen me korrupsionin në Shqipëri. Kjo qasje siguroi identifikimin e fushave me rrezik të lartë dhe përcaktimin e masave specifike për të adresuar në mënyrë efektive fenomenin e korrupsionit. Kjo analizë, u bazua në burime të ndryshme informacioni, duke përfshirë raportet e monitorimit për zbatimin e Strategjisë prej vitit 2015, raportet vjetore të Komisionit Evropian për Shqipërinë, vlerësimet e kryera në kuadër të GRECO, raportet e zbatimit të planeve të integritetit të zhvilluara në bashkëpunim me autoritetet publike, raportet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit bazuar në hetimet administrative të kryera, analizat e perceptimit për korrupsionin, raporte të shoqërisë civile, etj.

Krahas mangësive në zbatimin e Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023, në adresimin e këtyre prioriteteve ka ndikuar edhe mospërfshirja e disa niveleve të qeverisjes dhe autoriteteve publike në dokumentin e strategjisë. Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023 fokusohet vetëm në institucionet e administratës në nivel qendror dhe nuk parashikonte një mbulim të plotë territorial duke përfshirë kështu organet e njësive të vetëqeverisjes vendore në zbatimin e masave kundër korrupsionit. Për të siguruar një veprim

efektiv kundër korrupsionit, kërkohet një sinergji e veprimeve në të gjitha nivelet e qeverisjes. Kushtetuta dhe legjislacioni për vetëqeverisjen vendore i ka atribuar pushtetit vendor kompetenca të konsiderueshme normative, administrative dhe financiare që mund t'i ekspozojnë këto organe ndaj korrupsionit. Bashkitë kanë qenë të angazhuara në zhvillimin e planeve të integritetit, por në shumicën e rasteve u mungojnë kapacitetet dhe burimet e nevojshme për hartimin ose zbatimin e tyre. Për më tepër, niveli i dytë i vetëqeverisjes vendore, qarqet, nuk kanë qenë të përfshira në këtë proces.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 nuk parashikonte gjithashtu përfshirjen e plotë të organeve rregullatore, të cilat luajnë një rol kyç në zbatimin e politikave publike dhe garantimin e respektimit të kuadrit ligjor. Këto organe janë thelbësore për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm dhe të drejtë në fushat përkatëse. Ndër institucionet rregullatore të rëndësishme mund të përmenden: Enti Rregullator i Energjisë, Enti Rregullator i Ujit, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti Rregullator i Hekurudhave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti i Konkurrencës. Përfshirja e këtyre autoriteteve në strategjinë antikorrupsion është parë e domosdoshme për të siguruar një qeverisje të mirë dhe një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Këto institucione janë mbrojtësit kryesorë kundër korrupsionit në sektorët që mbikëqyrin dhe luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës dhe integritetit në shoqëri. Përmes funksioneve të tyre rregullatore, ato kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies, integritetit dhe forcimin e qeverisjes së mirë.

Korrupsioni në sektorin privat nuk ka qenë pjesë e fokusit të strategjisë për periudhën 2015-2023. Në një ekonomi tregu të lirë, biznesi privat është motori i zhvillimit, kështu që sigurimi i klimës së duhur të zhvillimit të biznesit mbi baza integriteti merr rëndësi thelbësore.

Në këtë fazë të zbatimit të reformave antikorrupsion, fokusi i strategjisë do të jetë në zbatimin e një qasjeje të qartë sektoriale për të adresuar riskun e korrupsionit në sektorë kyç si pronat, tatimet dhe doganat, shëndetësia, kontratat publike, dhe arsimiti. Pavarësisht ndikimit pozitiv të digjitalizimit të shumë shërbimeve në reduktimin e korrupsionit në këto fusha, mbetet ende punë për t'u bërë për të adresuar korrupsionin në sektorët më kritik dhe për të transformuar këta sektorë në shtytës të një ekonomie të qëndrueshme dhe të shëndetshme në Shqipëri.

Strategjia ofron gjithashtu një qasje të drejtpërdrejtë ndërhyrjeje në promovimin e edukimit dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit, me qëllim investimin e qëndrueshëm në mbrojtjen që në moshë të hershme me standardet e mirëqeverisjes, përmes lentes së rritjes së forcimit të edukimit për integritetin dhe ligjshmërinë, me qëllim fuqizimin e brezave të rinj që kanë si pikë reference vetëm standardet e integritetit dhe drejtësisë.

Për të garantuar qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e politikave për reduktimin progresiv të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e qeverisjes së mirë, Qeveria Shqiptare bashkërisht me të gjithë institucionet e tjera bashkëpërgjegjëse paraqet këtë strategji të re kundër korrupsionit, për periudhën 2024 - 2030.

3. Deklarata e vizionit

Vizioni

Duke marrë parasysh zhvillimet e deritanishme, vizioni i Strategjisë Ndërsektorale kundër Korrupsionit, 2024-2030 është: ***“Institucione publike që ushtrojnë funksionet në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike dhe ofrojnë shërbime efçente ndaj qytetarëve”.***

Ky vizion synohet që të jetësohet përmes tre qëllimeve të politikës:


Qëllimi i parë: Parandalimi i korrupsionit - Forcimi i mekanizmave ligjore dhe institucionale për të parandaluar korrupsionin dhe forcuar integritetin në administratën publike, me fokus në sektorët me risk të lartë ndaj korrupsionit.

Qëllimi i dytë: Ndëshkimi i korrupsionit - Rritja e performancës së të gjithë strukturave përgjegjëse për ndjekjen, hetimin, ndëshkimin e rasteve korruptive.

Qëllimi i tretë: Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit - Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të qytetarëve për t’u angazhuar në mënyrë proaktive në luftën kundër korrupsionit.

PJESA II

QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË SNKK 2024-2030



Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030, është e strukturuar në tri shtylla kryesore që pasqyrojnë qëllimet e politikave, përkatësisht: (I) parandalimi i korrupsionit, (II) ndëshkimi i korrupsionit, dhe (III) ndërgjegjësimi në luftën kundër korrupsionit.

Fushat e ndërhyrjes nën çdo qëllim politike përfshijnë:

(I) Zbatimi i mekanizmave efektivë dhe të standardizuar në përdorimin e instrumenteve kundër korrupsionit, në përputhje me parashikimet ligjore dhe institucionale, si dhe përmirësimi i kapaciteteve teknike dhe profesionale, mbetet një prioritet thelbësor. Gjithashtu, shtrirja e instrumenteve të integritetit në administratën publike, duke përfshirë autoritetet e pushtetit vendor, ka për qëllim forcimin e mekanizmave të kontrollit mbi përdorimin e fondeve publike. Përmirësimi dhe standardizimi i kuadrit rregullator kundër korrupsionit, përfshirë sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, rregullimin e lobimit, transparencën dhe kontrollin mbi financimin e partive politike, përbën një komponent kyç për realizimin e vizionit të SNKK 2024-2030. Po ashtu, theksohet rëndësia e zhvillimit të qëndrueshëm në sektorët më të ndjeshëm, si pronat, arsimit, shëndetësia, tatimet, doganat dhe kontratat publike, për të ulur në mënyrë efektive riskun e korrupsionit në këto fusha.

(II) Përmirësimin e koordinimit dhe rritjen e cilësisë së hetimeve administrative dhe penale kundër korrupsionit. Kjo ndërhyrje, kërkon bashkëpunim të thelluar gjyqësor dhe ngritjen e strukturave të forta për bashkëpunim operacional midis organeve ligjzbatuese. Sigurimi i një zbatimi efektiv të legjislacionit kundër korrupsionit përfshin hetimin dhe ndjekjen penale të veprave korruptive, duke garantuar gjithashtu që organet ligjzbatuese të kenë në dispozicion mjetet dhe burimet e nevojshme për hetime dhe procedura të plota dhe efektive në luftën kundër korrupsionit.

(III) Rritja e ndërgjegjësimit dhe nivelit të edukimit të publikut kundër korrupsionit do të zhvillohet si një prioritet kyç, duke theksuar rolin e rëndësishëm që luan edukimi në parandalimin e veprimeve korruptive. Investimi në këtë drejtim synon të informojë dhe të inkurajojë qytetarët të njohin rreziqet e korrupsionit si dhe të raportojnë rastet e korrupsionit në administratën shtetërore. Kjo ndërhyrje, konsiderohet thelbësore në forcimin e përgjegjshmërisë qytetare për luftimin e korrupsionit në të gjitha nivelet.

Të gjitha masat dhe veprimet për zbatim si dhe afatet kohore janë parashikuar në Planin e Veprimit në Aneksin nr.1.

QËLLIMI I PARË I POLITIKËS: "PARANDALIMI I KORRUPSIONIT" – Përbën shtyllën e parë të SNKK 2024-2030 dhe përfshin 9 Objektiva Specifikë. Ky Qëllim do të fokusohet në reformimin e kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit, si dhe forcimin e transparencës së institucioneve publike në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes. Gjithashtu, do të synohet përforcimi i sistemit të zbulimit të hershëm (sinjalizimi) dhe adresimi i korrupsionit përmes vlerësimeve sistematike të riskut të korrupsionit në sektorët e identifikuar me risk të lartë ndaj veprimeve korruptive.

Ndërhyrjet do të fokusohen paralelisht edhe në rritjen e transparencës së financimit të partive politike, mirëmenaxhimin e fondeve, burimeve financiare dhe asetëve publike. Njëkohësisht, do të synohet shtrirja e mekanizmave të korrupsionit në hallkat vendimmarrëse të pushtetit vendor, si dhe promovimi dhe ndërtimi i partneritetit për garantimin e një sektori privat që shërben si promotor i integritetit dhe bashkëpunon në mënyrë efikase me sektorin publik në luftën kundër korrupsionit.

Për zbatimin e kësaj pjese të strategjisë, Qeveria Shqiptare, nëpërmjet autoriteteve në nivel qendror dhe vendor, në bashkëpunim me organet e pavarura kushtetuese dhe organet e pushtetit gjyqësor, do të ndërmarrë ndërhyrje të dedikuara dhe do të sigurojë burimet e duhura, me qëllim zbatimin efektiv të tyre dhe matjen e progresit për secilin prej objektivave. Këto të dhëna do të analizohen mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Ky qëllim politik (I) synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

Objektivi Specifik 1.1: Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.

Objektivi Specifik 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Objektivi Specifik 1.3: Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni).

Objektivi Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Objektivi Specifik 1.5: Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Objektivi Specifik 1.6: Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit.

Objektivi Specifik 1.7: Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.

Objektivi Specifik 1.8: Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni.

Objektivi Specifik 1.9: Promovimi i integritetit në sektorin privat.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i parë i Politikës synon forcimin e mekanizmave ligjore dhe institucionale për të parandaluar korrupsionin dhe forcuar integritetin në administratën publike. Ky qëllim politik ka veçuar me përparësi fokusin e ndërhyrjes në disa sektorë me risk të lartë ndaj korrupsionit dhe ka promovuar një grup mekanizmash aktivë për luftën kundër korrupsionit. Politika e parandalimit përqendrohet në promovimin e institucioneve publike të mirëorganizuara dhe të qëndrueshme, si dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit.

Ky qëllim politik lidhet me objektivin nr. 16 të OZHQ: *“Paqe, siguri dhe institucione të forta dhe efektive”*.

Objektivi Specifik 1.1: Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Kuadri jonë kombëtar ligjor kundër korrupsionit përcakton të drejtat, detyrimet, kompetencat dhe procedurat në kuadër të luftës kundër korrupsionit për të gjitha institucionet zbatuese. Gjithashtu, ai rregullon bashkëpunimin dhe koordinimin midis institucioneve politikëbërëse, ekzekutive dhe atyre ligjzbatuese, duke synuar parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në mënyrë efikase. Pavarësisht faktit se aktualisht në vendin tonë ka një kuadër rregullator të ngritur në drejtim të luftës kundër korrupsionit, ende ka nevojë për përmirësime të mëtejshme nëpërmjet miratimit të ligjeve të reja dhe përmirësimit të legjislacionit ekzistues, për të harmonizuar më tej kuadrin tonë rregullator me standardet ndërkombëtare.

Nevoja për përmirësimin e legjislacionit do të identifikohet në bazë të rekomandimeve të gjeneruara nga organizatat ndërkombëtare për Shqipërinë dhe nëpërmjet shqyrtimit të hollësishëm të legjislacionit ekzistues, me synim prioritar përafrimin e legjislacionit me *acquis*-në dhe standardet e BE-së. Në këtë proces, Udhërrëfyeni për Shtetin e së Drejtës luan një rol thelbësor, pasi parashikon miratimin e ligjit “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, deri në vitin 2025; amendimin e ligjit “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, deri në vitin 2025, me qëllim përafrimin me *acquis*-në e BE-së; miratimin e ligjit “Për Lobimin”, deri në vitin 2027; miratimin e ligjit “Për Financimin e Partive Politike”, deri në vitin 2027; si dhe ratifikimin e Konventës “Për Luftimin e Ryshfetit të Zyrtarëve Publikë të Huaj në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit”, deri në vitin 2027.

Njëkohësisht, iniciativat ligjore në kuadër të kësaj strategjie janë të linjëzuara me rekomandimet e GRECO, përkatësisht Rekomandimi nr. 3 i Raundit të V-të, të Vlerësimit të GRECO, sipas të cilit duhet të synohet harmonizimi dhe rritja e koherencës së natyrshme të kuadrit ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë. Gjithashtu, nëpërmjet miratimit të Manualit “Për Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në legjislacion për shërbimet e Kuvendit” (*Corruption Proofing of Legislation*), do të intensifikohet vlerësimi dhe kontrolli i procesit të ligjvënësimit për të ulur riskun e korrupsionit që mund të vijë nga miratimi i një ligji të ri apo ndryshimit të tij, i cili do të shtrihet edhe në aktivitetin e strukturave teknike të Kuvendit.

Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit kërkon gjithashtu angazhimin e institucioneve të organizuara në mënyrë efikase me detyra dhe kompetenca të qarta, burime, njohuri dhe aftësi profesionale, dhe një shkallë të lartë bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet të gjithë aktorëve. Shqipëria ka një sistem të konsoliduar institucionesh që kanë kompetenca në drejtim të luftës kundër korrupsionit, që mbulojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të parandalimit dhe ndëshkimit të korrupsionit, me nivele të ndryshme kapacitetesh dhe ekspertize. Megjithatë,

organizimi dhe angazhimi i këtyre strukturave me qëllim rritjen e efektivitetit në drejtim të luftës kundër korrupsionit ka nevojë për përmirësim.

Plotësimi i kabinetit qeveritar prej janarit 2024 me pozicionin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, i cili njëkohësisht ushtron edhe kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, konsiderohet një dëshmi e vëmendjes së shtuar ndaj prioriteteve të deklaruara, në drejtim të luftës kundër korrupsionit për të sinergjizuar punën e institucioneve të ekzekutivit në raport me politikën antikorrupsion të qeverisë dhe zbatuar të gjitha zotimet, në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies. Me qëllim garantimin e zbatimit efikas të kuadrit strategjik antikorrupsion, sistemi gjithëpërfshirës i organeve që veprojnë në luftën antikorrupsion ka nevojë për forcim dhe përmirësim të bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit të mëtejshëm.

Nevoja për përmirësimin e kapaciteteve institucionale të organeve të pajisura me kompetenca në luftën kundër korrupsionit do të identifikohet në bazë të vlerësimit të kapaciteteve aktuale profesionale dhe financiare të të gjitha institucioneve përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit, krahasimisht me kapacitetet e planifikuara dhe të nevojshme. Ndërkohë që, nevoja për përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit të institucioneve kundër korrupsionit do të identifikohet duke vlerësuar sfidat në këto procese, bashkërisht me masat që duhet të ndërmerren për adresimin e problematikave të evidentuara. Ky bashkëpunim, do të vlerësohet në mënyrë sistematike në takimet periodike që do të zhvillohen mes autoriteteve të përfshira në luftën kundër korrupsionit.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.1 synon të adresojë të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e evidentuara në vlerësimet e performancës së institucioneve shqiptare nga mekanizmat kombëtare dhe ndërkombëtare shtetërore dhe jo-shtetërore. Këto gjetje do të reflektohen përmes miratimit dhe rishikimit të akteve ligjore dhe masave me karakter institucional që duhet të ndërmerren në vijim nga autoritetet shqiptare.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Forcimi i kuadrit ligjor për parandalimin e korrupsionit.

Rezultati 2: Forcimi i vazhdueshëm i kuadrit institucional në parandalimin e korrupsionit.

Rezultati 3: Struktura shtetërore të përgatitura dhe me kapacitete e mekanizma antikorrupsion në veprim.

Rezultati 4: Sigurim i procedurave administrative standarde në përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit të parandalimit të korrupsionit.

Rezultati 5: Administratë publike rezistente dhe funksionale kundër korrupsionit (kapacitete teknike funksionale).

Institucione Kryesore: Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Kuvendi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Këshilli i Ministrave, Ministritë e Linjës, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Institucionet zbatuese të SNKK, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Institucione Kontributore: Institucionet zbatuese të SNKK, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministritë e Linjës, Kuvendi, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

organizimi dhe angazhimi i këtyre strukturave me qëllim rritjen e efektivitetit në drejtim të luftës kundër korrupsionit ka nevojë për përmirësim.

	Objektivi Specifik 1.1: Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.
1.1.1	Masa: Forcimi i kuadrit ligjor për parandalimin e korrupsionit.
1.1.2	Masa: Përmirësimi i procedurave administrative në përgatitjen dhe miratimin e legjislacionit për parandalimin e korrupsionit.
1.1.3	Masa: Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale teknike për parandalimin e korrupsionit.
1.1.4	Masa: Forcimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet institucioneve parandaluese kundër korrupsionit.

Lidhja e treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.1.1 Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore (aktet e brendshme dhe marrëveshjet ndërkombëtare) të miratuara nga ato të planifikuara për t'u miratuar.	Forcimi i mekanizmave ligjore dhe institucionale për të parandaluar korrupsionin dhe forcuar integritetin në administratën publike.	1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.	KKKK Kuvendi
Rezultati	1.1.2 Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë ngritur dhe vënë në funksion strukturat antikorrupsion.	Forcimi i mekanizmave ligjore dhe institucionale për të parandaluar korrupsionin dhe forcuar integritetin në administratën publike.	1.1 Forcimi i kornizës ligjore dhe kapaciteteve institucionale në parandalimin e korrupsionit.	KKKK

Objektivi Specifik 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes

Analiza e situatës dhe sfidat

Transparenca, përgjegjshmëria, integriteti dhe lufta kundër korrupsionit janë angazhime të qarta të Shqipërisë në kuadër të reformave dhe procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Në këtë drejtim, vendi ynë ka konsoliduar në mënyrë sistematike ndërhyrjet përkatëse në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke i adresuar nevojat për përmirësim në mënyrë të vazhdueshme, për të forcuar akoma më tej luftën kundër korrupsionit, për të siguruar një parandalim dhe koordinim më efektiv të veprimeve. Në këtë kontekst, ky kuadër strategjik do të ndihmojë më tej në promovimin e një administratë publike më të përgjegjshme dhe transparente. Transparenca e institucioneve publike, në të gjitha nivelet e Qeverisjes, përbën bazën për monitorimin e punës së tyre. Llogaridhënia e autoriteteve publike parandalon abuzimin e pushtetit, teksa kryerja e veprimtarisë institucionale me integritet dhe në përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi parandalon sjelljet joetike. Për këtë arsye, këto elementë kanë një rol thelbësor në parandalimin e korrupsionit gjatë ushtrimit të veprimtarisë shtetërore.

Transparenca e institucioneve publike në Shqipëri është përmirësuar ndjeshëm me digjitalizimin e 95% të shërbimeve publike, deri në fund të vitit 2023, teksa ka ende hapësirë dhe nevojë për vazhdimin dhe përmirësimin e aksesit të lirë në informacion dhe shtimin e numrit të institucioneve që ndjekin parimet e Qeverisjes së Hapur. Portali qeveritar e-Albania, që ofron në mënyrë elektronike shërbimet publike të ofruara dikur në zyrat dhe sportelet fizike të institucioneve, është padyshim një histori suksesi në këtë drejtim. Ky portal vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare për qytetarët dhe bizneset 24/7.

Nevoja për përmirësimin dhe standardizimin e shërbimeve në drejtim të transparencës pritet të forcohet duke ruajtur dhe përmirësuar shërbimet e ofruara deri më tani si dhe njëkohësisht, nëpërmjet riinxhinierimit të të gjithë shërbimeve publike.

Raportimi vjetor i performancës së institucioneve publike, vlerësohet gjithashtu të jetë vlerë e shtuar e transparencës në zbatim të drejtës së informimit, për të lehtësuar aksesin në informacionin publik. Megjithatë, transparenca proaktive duhet të avancojë më tej përmes nxitjes së publikimit të Regjistrave të Indekseve të Transparencës dhe përmirësimin të Manualit për të Drejtën e Informimit.

Llogaridhënia dhe kontrolli i besueshëm i ushtrimit të mekanizmave të zbatimit të instrumenteve antikorrupsion është përmirësuar gjithashtu edhe nëpërmjet dorëzimit online të deklaratave të pasurive dhe interesave. Nevojitet ende të përmirësohet transparenca dhe aksesueshmëria e deklaratave të interesave private, si dhe të forcohet në vijimësi auditimi i tyre. Deklaratat e pasurisë, regjistrat e dhuratave, ngritja dhe administrimi i tyre në kuadër të aktivitetit publik zyrtar, në ushtrim të detyrës shtetërore, janë garancia më e mirë kundër korrupsionit. Institucionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes duhet të sigurojnë zbatimin e standardeve më të larta të integritetit dhe të kontrollit, si mënyra efektive për të përballuar korrupsionin gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Kjo do të kontribuojë në ndërtimin e një administrate më të përgjegjshme dhe transparente, e cila promovon besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Kryerja e vlerësimeve të riskut dhe përgatitja e Planeve të Integritetit në të gjithë Ministrinë e Linjës dhe institucionet e tjera, përfshirë ato të Qeverisjes Lokale ka përmirësuar garantimin e

integritetit në të gjitha nivelet e qeverisjes. Megjithatë, vlerësohet se standardizimi i mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Planeve të Integritetit, mbështetur në vendosjen e një pasaporte treguesish, do të rrisë efektivitetin e përdorimit të tyre dhe do të shërbejë si një bazë e mirë të dhënash për nisma të ardhshme politike, jo vetëm nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, por edhe në bashkëpunim me partnerë të shoqërisë civile. Kodet e Etikës janë aktualisht në fuqi dhe procesi për përmirësimin e zbatimit të tyre vazhdon, me mbështetjen e projekteve ndërkombëtare.

Zyrtarët janë të detyruar të raportojnë interesat e tyre në deklaratat përkatëse të interesave, dhe rastet e konfliktit të interesit i nënshtrohen hetimit administrativ. Sidoqoftë, mbetet e nevojshme vazhdimi dhe përmirësimi i këtyre proceseve për të garantuar një zbatim më të efektshëm të ligjit dhe për të rritur transparencën.

Për më tepër, procedurat për monitorimin dhe zbatimin e Kodit të Etikës në të gjitha nivelet e qeverisjes, duke përfshirë edhe rregullat e veçanta për funksionarët politikë, do të përmirësohen dhe do të përgatitet një manual i dedikuar. Ky kuadër, i harmonizuar dhe në përputhje me legjislacionin dhe institucionet që luftojnë korrupsionin dhe mbrojnë integritetin e zyrtarëve publikë dhe funksionarëve politikë, sipas kërkesave të GRECO (Raundi V për Shqipërinë), do të rrisë dhe standardizojë veprimet në këto fusha, duke kontribuar në përmirësimin e performancës institucionale dhe qeverisëse.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.2 synon të adresojë të gjitha ato rekomandime dhe ndërhyrje të pritshme dhe që mbeten në proces nga Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023, për të mundësuar zbatimin efikas të mekanizmave kryesorë parandalues që prekin veprimtarinë e përditshme të organeve të administratës në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Rritja e transparencës dhe monitorimit në proceset administrative dhe të shërbimeve të ofruara për publikun.

Rezultati 2: Pjesëmarrja proaktive e aktorëve në institucionet publike, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike.

Rezultati 3: Përmirësimi i llogaridhënies dhe performancës publike të zyrtarëve dhe nëpunësve të shtetit.

Rezultati 4: Rritja e kapaciteteve profesionale, me qëllim rritjen e efikasitetit gjatë ushtrimit të detyrës.

Rezultati 5: Rritja e besimit qytetar në institucionet publike.

Institucione Kryesore: Ministritë e Linjës, Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Këshilli i Ministrave/Ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Kuvendi, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Institucione Kontributore: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shkolla Shqiptare e

Administratës Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Institucionet zbatuese të SNKK, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Akademia e Sigurisë, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Departamenti i Administratën Publike, Ministria e Drejtësisë.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes.
1.2.1	Masa: Forcimi i transparencës së institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.
1.2.2	Masa: Forcimi i llogaridhënies së institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.
1.2.3	Masa: Forcimi i integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.
1.2.4	Masa: Përmirësimi i bashkëpunimit midis AMP dhe Policisë Ushtarake, Drejtorisë së Tatimeve dhe struktura të tjera policore me fokus numrin e sanksioneve (masave) të dhëna për zyrtarët e agjencive të zbatimit të ligjit për shpërdorim detyre dhe korrupsion.
1.2.5	Masa: Hartimi i një kuadri të harmonizuar dhe në koherencë me kuadrin ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë dhe funksionarët politikë (duke reflektuar rekomandimin nr. iii, të Round V të GRECO për Shqipërinë).
1.2.6	Masa: Module për integritetin dhe parandalimin e korrupsionit të përfshira në programin e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.2.1 Përqindja e institucioneve publike qendrore dhe vendore që kanë në përdorim regjistrë elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve (trend rritës).	Institucionet publike mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike, përmirësimi i llogaridhënies të zyrtarëve të shtetit.	1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.	KDIMDP
Rezultati	1.2.2 Përqindja e deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë, të dorëzuara dhe të audituara, nga numri total që duhet të dorëzohen.	Institucionet publike mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike, përmirësimi i llogaridhënies të zyrtarëve të shtetit.	1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes	ILDKPKI
Rezultati	1.2.3 Përqindja e institucioneve publike, (qendrore, vendore) dhe organeve të pushtetit gjyqësor që kanë hartuar plane integriteti (kode etike) (trend rritës).	Institucionet publike mundësojnë pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike, përmirësimi i llogaridhënies të zyrtarëve të shtetit.	1.2 Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes.	KKKK

Objektivi Specifik 1.3: Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit)

Analiza e situatës dhe sfidat

Pavarësisht faktit se Shqipëria ka bërë hapa të konsiderueshme në vlerësimin e riskut të korrupsionit, prevalenca mbetet e lartë në disa sektorë ku kontakti me publikun dhe grupe të caktuara interesi me institucionet është edhe më i shpeshtë. Kjo dukuri është veçanërisht e pranishme në sektorin e të drejtave të pronësisë, kujdesit shëndetësor dhe social, arsimit, kontratave publike, tatimeve dhe doganave, të cilat kanë një ndikim të madh në qeverisje, ekonomi dhe shoqëri në tërësi, veçanërisht në nivelin e besimit të publikut ndaj institucioneve publike.

Adresimi i risqeve të korrupsionit në sektorin e pronave është thelbësor për konsolidimin e një sistemi transparent dhe të përgjegjshëm për ofrimin efikas të shërbimeve kadastrale, ndërsa parandalimi i korrupsionit në sistemin e kujdesit shëndetësor dhe social është në përputhje me të drejtat themelore dhe sigurimin e aksesit të barabartë për kujdes shëndetësor cilësor. Nga ana tjetër, kontrolli më i mirë i procedurave në shërbimet e ofruara nga administrata tatimore do të reduktojë evazionin fiskal, si dhe do të rrisë efikasitetin e monitorimit të veprimeve ose mosveprimeve të zyrtarëve në sektorin tatimor dhe përfshirjen e tyre në raste të abuzimit të detyrës. Vlerësimi i riskut të korrupsionit në sektorin e kontratave publike gjithashtu do të reduktojë problematikat dhe ankesat që vijnë nga operatorët ekonomikë dhe investitorët, vendas dhe të huaj, ndërsa parandalimi i korrupsionit në procedurat doganore, kontrollet dhe

vlërësimet nga administrata doganore do të rrisë efincencën dhe llogaridhënien e sektorit doganor.

Nga sa më sipër, parandalimi i korrupsionit në këta sektorë do të përmirësohet duke kryer së pari, një vlerësim të thelluar dhe të detajuar të riskut të korrupsionit për secilin sektor për identifikimin e proceseve dhe procedurave më të ekspozuara ndaj korrupsionit, si dhe formave të shfaqjes së tij. Për këtë qëllim, do të zhvillohet një metodologji për kryerjen e vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorin publik, e përshtatur më pas për vlerësimet e riskut në secilin sektor, veçanërisht në sektorët e evidentuar me risk të lartë ndaj incidencës së korrupsionit.

Zbatii i metodologjisë do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe institucioneve shtetërore përkatëse që janë përgjegjëse për këta sektorë.

Pas kryerjes së vlerësimeve të riskut në të gjithë sektorët, do të hartohen masa të posaçme për parandalimin e korrupsionit në shërbime dhe procedura, të cilat do të adresojnë hapësirat abuzive të identifikuara në mangësitë e ofrimit të shërbimeve. Qëllimi është të sigurohet një trajtim sistemik i të gjitha mundësive potenciale për korrupsion. Të gjithë mekanizmat parandalues do të sistematizohen në Plane Veprimi për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk të lartë. Zbatimi i masave antikorrupsion në sektorët vulnerabël, si menaxhimi i pronës, kujdesi shëndetësor dhe social, arsimit, prokurimet publike, partneritetet publike-private, taksat dhe doganat, do të përfshijë zbatimin, monitorimin e vazhdueshëm, raportimin, ngritjen e kapaciteteve, angazhimin e palëve të interesuara dhe ndërgjegjësimin publik. Ky proces do të zhvillohet në përputhje me masat dhe aktivitetet e tjera të parashikuara në strategji, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme për parandalimin e korrupsionit në këta sektorë të rëndësishëm.

Këto masa pritet të krijojnë një qasje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk të lartë dhe të japin një kontribut të rëndësishëm në reformat antikorrupsion, duke synuar mirëfunksionimin e administratës publike. Një përparësi e rëndësishme për Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit (KKKK) do të jetë sigurimi që parandalimi i korrupsionit të integrohet në mënyrë të plotë përmes hartimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve (planeve të veprimit), si dhe përmes vlerësimit të tyre të vazhdueshëm.

Kjo do të arrihet përmes një rivlerësimi të plotë në përfundim të ciklit tre-vjeçar të zbatimit të masave, duke identifikuar risqet e korrupsionit në sektorë të tjerë potencialë, siç janë ndërmarrjet shtetërore, infrastruktura dhe mjedisi. Ky proces do të sigurojë që masat antikorrupsion të jenë të përshtatshme dhe efektive në parandalimin e korrupsionit në sektorë të ndryshëm dhe që u përgjigjen dinamikave të zhvillimit në këta sektorë.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.3 synon të adresojë të gjitha ato rekomandime dhe kërkesa të evidentuara në raport progreset e KE për vendin, angazhimet e marra në komponentin antikorrupsion të Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, por edhe raporte vlerësimi të tjera, për të mundësuar ndërhyrjen, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike dhe kthimin e besimit të qytetarëve në luftën ndërinstitucionale kundër korrupsionit.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Krijimi i mekanizmave standardë për vlerësimin periodik dhe të rregullt të korrupsionit në sektorët me risk dhe përhapje të lartë të korrupsionit.

Rezultati 2: Monitorimi i rregullt i sektorëve më të cenueshëm e të prekur nga korrupsioni për të identifikuar dhe zbatuar ndërhyrjen e përshtatshme me qëllim zbulimin, parandalimin dhe/ose ndëshkimin e korrupsionit.

Rezultati 3: Hulumtimi i vazhdueshëm dhe analiza për të vlerësuar rezultatet e ndërhyrjeve në sektorët/institucionet që janë më të rrezikuar ose të cenueshëm ndaj korrupsionit.

Rezultati 4: Ofrimi i shërbimeve kadastrale efikase dhe transparente.

Rezultati 5: Rritje e konkurrencës së ndershme gjatë proceseve të prokurimeve publike.

Rezultati 6: Ofrimi i shërbimeve tatimore dhe doganore proceduralisht të mirërregulluara dhe të kontrolluara për të siguruar transparencë dhe efikasitet.

Rezultati 7: Arsimit dhe sistem shëndetësor cilësor dhe efikas për qytetarët.

Institucione Kryesore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, Drejtoria e Përgjithshme e Trajnimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Institucionet e varësisë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Institucione Kontributore: Agjencia e Trajtimit të Pronës, Dhoma të Tregtisë dhe Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Ministrinë e Linjës, Autoritetet Kontraktore, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 1.3: Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë korrupsioni)
1.3.1	Masa: Parandalimi i korrupsionit në sektorin publik.
1.3.2	Masa: Parandalimi i korrupsionit në menaxhimin e sektorit të pronave.
1.3.3	Masa: Parandalimi i korrupsionit në sistemin shëndetësor dhe kujdesin social.
1.3.4	Masa: Parandalimi i korrupsionit në fushën e arsimit parauniversitar.
1.3.5	Masa: Parandalimi i korrupsionit në fushën e prokurimeve publike.
1.3.6	Masa: Parandalimi i korrupsionit në fushën e partneritetit publik - privat.
1.3.7	Masa: Parandalimi i korrupsionit për administratën tatimore.
1.3.8	Masa: Parandalimi i korrupsionit në sistemin e doganave.
1.3.9	Masa: Parandalimi i korrupsionit në sektorë të tjerë publikë, të ndjeshëm për ekonominë dhe publikun.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.3.1 Raporti i numrit të vlerësimeve të riskut të korrupsionit të kryera me numrin e sektorëve/institucioneve me rrezik të lartë për korrupsion (trend rritës).	Monitorimi i rregullt i sektorëve më të cenueshëm/prekur nga korrupsioni për të identifikuar dhe zbatuar ndërhyrjen e përshtatshme me qëllim zbulimin, parandalimin dhe/ose ndëshkimin e korrupsionit.	1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit).	KKKK
Rezultati	1.3.2 Raporti i numrit të planeve të veprimit të kryera për parandalimin e korrupsionit, nga numri i sektorëve/institucioneve me rrezik të lartë për korrupsion (trend rritës).	Monitorimi i rregullt i sektorëve më të cenueshëm/prekur nga korrupsioni për të identifikuar dhe zbatuar ndërhyrjen e përshtatshme me qëllim zbulimin, parandalimin dhe/ose ndëshkimin e korrupsionit.	1.3 Zhvillimi i një qasjeje të qëndrueshme për parandalimin e korrupsionit në sektorët me risk (prevalencë të lartë të korrupsionit).	KKKK

Objektivi Specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

Analiza e situatës dhe sfidat

Decentralizimi i qeverisjes vendore garanton ushtrimin e kompetencave vendimmarrëse dhe administrative në nivel lokal, duke ofruar një gamë të gjerë instrumentesh financiare për shfrytëzim nga autoritetet vendore. Megjithatë, me këtë zgjerim të kompetencave, rritet edhe ndjeshmëria ndaj korrupsionit. Shqipëria ka bërë përparime të vazhdueshme në rritjen e kapaciteteve të autoriteteve vendore për të luftuar praktikatat korruptive, edhe pse mbetet ende punë për t'u bërë në drejtim të konsolidimit të tyre. Në këtë kontekst, janë kryer vlerësime të kornizës rregullatore dhe konsultime të gjera me institucionet e vetëqeverisjes vendore, duke u fokusuar në promovimin e sjelljes etike dhe integritetit. Vendosja e parimeve të qarta të sjelljes etike dhe krijimi i një kulture integriteti janë elementë kyç për të forcuar luftën kundër korrupsionit në nivel lokal.

Procesi i decentralizimit kontribuon në forcimin e llogaridhënies duke e afruar qeverisjen me qytetarët. Megjithatë, rritja e kontakteve midis zyrtarëve vendorë dhe qytetarëve gjatë këtij procesi mund të rrisë edhe rrezikun e sjelljeve joetike dhe mungesës së integritetit, duke rritur kështu mundësinë e shfaqjes së praktikave që minojnë transparencën dhe përgjegjshmërinë. Për këtë arsye, është thelbësore që të ndërmerren masa menaxhuese proaktive për të parandaluar dhe menaxhuar këto risqe, duke krijuar një qasje të qëndrueshme ndaj integritetit dhe llogaridhënies në qeverisjen vendore. Në këtë kontekst, hartimi i Planeve të Integritetit dhe planeve të veprimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe monitorimi i realizimit të tyre, ofrojnë një kuadër konceptual të qartë për zhvillimin e politikave dhe masave që synojnë

parandalimin e shkeljeve të integritetit të zyrtarëve publikë. Këto plane shërbejnë si mjete konkrete për adresimin dhe menaxhimin e risqeve të lidhura me integritetin, duke përmirësuar transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë në nivelin vendor, duke siguruar që zyrtarët publikë të përmbushin standardet e larta etike gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Instrumentet e integritetit kanë filluar tashmë të hartohen dhe miratohen në nivel vendor, si një mekanizëm për të kuptuar dhe adresuar më mirë rrezikun e korrupsionit brenda institucionit, duke rritur angazhimin e administratës publike për transparencë dhe llogaridhënie. Deri në fund të vitit 2023, 24 nga 61 bashki, miratuan Planet e Integritetit dhe njëkohësisht kanë caktuar koordinatorët e integritetit si mekanizma për të siguruar zbatimin e tyre.

Për të përmirësuar parandalimin e korrupsionit në të gjitha nivelet e Qeverisjes, vendi duhet të vazhdojë përpjekjet e tij për të forcuar kapacitetet e autoriteteve të vetëqeverisjes vendore në luftën kundër korrupsionit, së bashku me instrumentet lidhëse midis instucioneve qendrore dhe vendore në këtë fushë. Kjo do të arrihet përmes një vlerësimi të detajuar të gjendjes aktuale të çështjeve në parandalimin e korrupsionit në nivel vendor, veçanërisht në lidhje me vlerësimin e kryer të riskut të korrupsionit dhe planeve të integritetit të përgatitura dhe të miratuara.

Kryerja e vlerësimit të riskut në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku nuk janë kryer ende, do të nxitet dhe mbështetet duke përdorur një metodologji që do të përshtatet me specifikat për kryerjen e një vlerësimi të tillë në nivel vendor. Kjo do të pasohet nga përgatitja gjithashtu e një modeli të Planit të Integritetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore që do të marrë parasysh të gjitha gjetjet nga vlerësimet e riskut dhe praktikat më të mira në nivel vendi, por edhe eksperiencat rajonale dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Për të kryer dhe mbështetur këto procese, është e domosdoshme të rriten kapacitetet profesionale të stafeve teknike të bashkive dhe qarqeve, me njohuri konkrete dhe të vazhdueshme në parandalimin e korrupsionit dhe të kuadrit ligjor dhe rregullator për integritetin. Në këtë drejtim, roli i pikave të kontaktit antikorrupsion bëhet vendimtar për koordinimin ndërinstucional. Pika të kontaktit antikorrupsion në bashki dhe qarqe do të konsiderohen stafet teknike që do të jenë përgjegjëse për zbatimin e strategjisë ndërsektorale kundër korrupsionit dhe raportimin e zbatimit të saj, sikurse koordinatorët e integritetit që janë persona të ngarkuar me ndjekjen dhe zbatimin e instrumenteve të integritetit dhe koordinatorët e të drejtës së informimit. Strukturat e burimeve njerëzore pranë tyre duhet të jenë të informuara për ngritjen dhe administrimin e instrumenteve parandalues të korrupsionit, përfshirë këtu regjistrin e dhuratave, deklaramentit të konfliktit të interesave, apo sinjalizimit.

Për realizimin e këtij qëllimi, merr një rëndësi të veçantë forcimi i bashkëpunimit mes Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe institucioneve të tjera antikorrupsion në bashkitë dhe qarqet përmes emërimit të pikave të kontaktit antikorrupsion. Rritja e komunikimit dhe vizibilitetit, me qëllim rritjen e transparencës të aktivitetit të bashkive dhe qarqeve konsiderohet gjithashtu një vlerë e shtuar dhe siguron zbatimin e mirë të mekanizmave antikorrupsion, duke bërë partnerë direkt edhe organet kolegjiale të Këshillave Bashkiakë, si autoritetet ku miratohen politikat e integritetit dhe monitorhet zbatimi i tyre.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.4 synon adoptimin dhe integrimin në veprimtarinë institucionale të politikave të luftës kundër korrupsionit edhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto njësi

duhet të kenë të ngritura mekanizmat dhe të kenë në zbatim instrumente antikorrupsioni njësoj sikurse ato që aplikohen edhe në organet e administratës qendrore.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve për të koordinuar zbatimin e politikës antikorrupsion në nivel vendor.

Rezultati 2: Forcimi i mekanizmave të pushtetit vendor në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin periodik të strategjisë kundër korrupsionit dhe kornizës kundër korrupsionit.

Rezultati 3: Krijimi i Rrjetit të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion në institucionet e pushtetit me kompetenca vendore.

Rezultati 4: Rritja e rolit të Këshillave Bashkiakë në forcimin e integritetit dhe zbatimin e politikave antikorrupsion në nivel vendor.

Institucione Kryesore: Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Bashkitë, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Institucione Kontributore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Qarqet, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 1.4: Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
1.4.1	Masa: Identifikimi i mënyrave për të përmirësuar parandalimin e korrupsionit në të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
1.4.2	Masa: Fuqizimi i mekanizmave për parandalimin efektiv të korrupsionit në të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.
1.4.3	Masa: Zbatimi i mekanizmave parandalues të përshtatur me specifikat e Vetëqeverisjes Vendore.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.4.1 Raporti i numrit të bashkive dhe qarqeve që kanë kryer vlerësime të riskut të korrupsionit nga numri i atyre që ende nuk e kanë kryer (trend rritës).	Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve për të koordinuar zbatimin e politikës antikorrupsion në nivel vendor.	1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në qeverisjen vendore.	AMVV Bashkitë Qarqet
Rezultati	1.4.2 Raporti i numrit të bashkive dhe qarqeve që kanë përgatitur Plane Integriteti nga numri i atyre që ende nuk e kanë përgatitur (trend rritës).	Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve për të koordinuar zbatimin e politikës antikorrupsion në nivel vendor.	1.4 Forcimi i mekanizmave të parandalimit të korrupsionit në qeverisjen vendore.	AMVV Bashkitë Qarqet

Objektivi Specifik 1.5: Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik

Analiza e situatës dhe sfidat

Besimi tek institucionet dhe organet që ushtrojnë kompetenca kontrolli dhe vlerësimi ka një ndikim thelbësor në rritjen e besueshmërisë së reformave të ndërmarrë nga Shqipëria për luftën kundër korrupsionit. Ky besim kontribuon në legjitimitetin e këtyre reformave, duke siguruar që qytetarët të shohin përpjekjet e qeverisë si të besueshme dhe të efektshme. Për më tepër, organet e kontrollit dhe vlerësimit luajnë një rol kyç në sigurimin e llogaridhënies dhe transparencës, të cilat janë shtylla kryesore në luftën kundër korrupsionit dhe përforcimin e qeverisjes së mirë.

Përgjatë viteve, janë ndërmarrë disa hapa për të forcuar kuadrin institucional dhe për të përmirësuar mekanizmat e mbikëqyrjes financiare dhe ekonomike, mes të cilave vlen të përmenden përmirësimi i auditimeve të brendshme dhe të jashtme për të siguruar më shumë transparencë dhe përgjegjshmëri në përdorimin e fondeve publike. Ministria e Financave ka konsoliduar një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin e korrupsionit dhe kontrollin e keqmenaxhimit të asetëve publike. Nëpërmjet krijimit të mekanizmave të inspektimit në institucionet publike dhe përmirësimeve në planifikimin dhe menaxhimin financiar, përfshirë edhe kontrollin e proceseve të prokurimit, është rritur gradualisht efikasiteti i përgjithshëm i investimeve publike. Këto masa kanë ndihmuar në instalimin e një politike të tolerancës zero ndaj korrupsionit, duke forcuar transparencën dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin e burimeve publike.

Qeveria Shqiptare ka miratuar Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030 dhe Planin e Veprimit 2023-2026,¹⁴ të cilat cila parashikojnë krijimin e një sistemi të menaxhimit të financave publike

¹⁴ Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 390, datë 12.6.2024, "Për miratimin e strategjisë sektoriale të menaxhimit të financave publike, 2023-2030".

bazuar në transparencë, llogaridhënie, disiplinë fiskale, efikasitet dhe barazi në përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara dhe sigurimin e një zhvillimi ekonomik sipas standardeve të BE-së. Sistemet për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik janë përmirësuar duke siguruar mekanizmat e menaxhimit të shëndoshë financiar. Koncepti i llogaridhënies menaxheriale dhe delegimit të autoriteteve është forcuar duke adresuar mangësitë e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në institucionet publike.

Auditimet e brendshme zhvillohen në të gjitha institucionet publike në përputhje me standardet ligjore në fuqi. Rastet e mashtrimit dhe parregullsive në administratën publike trajtohen në mënyrë efektive nga Inspektimi Financiar Publik dhe Rrjeti i Shërbimit të Koordinimit Kundër Mashtrimit. Për këtë qëllim, janë krijuar sisteme të përshtatshme të menaxhimit financiar për të përthithur në mënyrë sa më efikente mbështetjen financiare të IPA-III dhe IPA-ve të ardhshme të BE-së.

Njëkohësisht, gjatë viteve, funksioni i pavarur i Kontrollit të Lartë të Shtetit është zbatuar në mënyrë të rregullt dhe të qëndrueshme, në përputhje me parimet e Organizatës Ndërkombëtare të Standardeve të Auditimit (ONISA) dhe standardet ndërkombëtare të auditimit. Kjo ka siguruar që aktivitetet e auditimit të jenë transparente, të paanshme dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, duke kontribuar në përmirësimin e menaxhimit të burimeve publike dhe rritjen e llogaridhënies në administratën publike. Raportimi vjetor i Kontrollit të Lartë të Shtetit në Kuvend dhe bashkëpunimi me strukturat parlamentare është intensifikuar, duke i mundur Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat të ushtrojë në mënyrë më efektive rolin e tij mbikëqyrës dhe kontrollues.

Mbrojtja e financave dhe aseteve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik ka qenë një nga fushat prioritare të mbuluara në Strategjinë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023, nga ku rezulton se, institucionet buxhetore kanë vijuar të zhvillojnë dhe zbatojnë Plane për Përmirësimin e Sigurimit të Cilësisë (PPSC) dhe të ofrojnë Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) dhe trajnime të tjera për audituesit e brendshëm përmes programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të trajnimit (CEF). Audituesit e brendshëm në vend, prej të cilëve 90% janë të certifikuar, luajnë një rol kyç në mbrojtjen e financave dhe aseteve publike. Ky proces, është thelbësor për garantimin e cilësisë dhe efektivitetit të mekanizmave të kontrollit, si në nivelin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm. Në këtë kuadër, mbrojtja e financave publike shihet si një komponent thelbësor i luftës kundër korrupsionit, duke forcuar strukturat e kontrollit dhe rritjen e llogaridhënies në sektorin publik. Kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm përbëjnë format më efektive të parandalimit të abuzimeve financiare, duke ndihmuar në rritjen e transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e burimeve publike.

Lufta kundër korrupsionit në menaxhimin e financave publike duhet vlerësuar edhe si një angazhim gjithëpërfshirës i autoriteteve publike që kanë rol në monitorimin dhe rregullimin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë dhe socialë. Përgjithësisht organet me kompetenca të zbatimit të politikave siç janë entet rregullatorë duke përmendur si: Enti Rregullator i Energjisë, Enti Rregullator i Ujit, Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti Rregullator i Hekurudhave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës. Këto organe janë krijuar dhe sigurojnë që veprimtaritë në tregje të caktuara të zhvillohen në mënyrë transparente e ligjore për të mbrojtur interesat e konsumatorëve, që janë qytetarët e vendit, duke promovuar konkurrencën e lirë, si parakusht për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit. Për këtë qëllim synohet që kapacitet teknike e profesionale të enteve rregullatore, duhet të mbahen në të njëjtat standarde, duke u mbështetur në të njëjtin përkushtim për parandalimin e korrupsionit, por edhe zbatimin e rregullave ligjore, si dhe ngritjen e ekipeve të ekspertizës së nivelit të lartë.

Një nga risitë e rëndësishme të kësaj strategjie është përfshirja e qasjes antikorrupsion në punën e inspektorateve. Për të siguruar një zbatim efektiv të këtij angazhimi, do të realizohet identifikimi i mundësive për integrimin e kuadrit antikorrupsion në aktivitetet e tyre inspektuese. Bazuar në këto gjetje, do të përgatitet një manual i posaçëm për përfshirjen e qasjes antikorrupsion në punën e inspektorateve, duke përfshirë udhëzimet për mënyrat e komunikimit, koordinimit dhe raportimit. Për më tepër, do të organizohen trajnime të dedikuara për stafin, me qëllim forcimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e një qasjeje të integruar në proceset inspektuese.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me objektivin specifik

Objektivi Specifik 1.5 synon të sigurojë normimin dhe zbatimin e kontrollit të rregullt për përdorimin e fondeve të buxhetit e financave të shtetit. Riorganizimi i strukturave të inspektimit dhe rritja e frekuencës së kontrolleve do të përbëjë garanci të shtuar për përdorimin cilësor dhe në kohë të fondeve të planifikuara.

Rezultate të pritshme për këtë objektivi përmenden:

Rezultati 1: Forcimi i efektivitetit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe të kontrollit financiar.

Rezultati 2: Forcimi i kapaciteteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, dhe inspektorëve financiarë.

Rezultati 3: Monitorim i përmirësuar i procedurave të prokurimit publik dhe të shpenzimeve publike.

Institucione Kryesore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Inspektorati Qendror, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Ministria e Financave, Kontrolli i Lartë i Shtetit, entet rregullatore.

Institucione Kontributore: Institucionet zbatuese të SNKK, Ministrinë e Linjës, Bashkitë, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Ministria e Financave, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, entet rregullatore, sektori privat.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektivi Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 1.5. Mbrojtja e financave dhe aseteve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik
1.5.1	Masa: Forcimi i rolit të inspektimeve në parandalimin e korrupsionit.
1.5.2	Masa: Forcimi i rolit të auditimeve të brendshme dhe të jashtme në parandalimin e korrupsionit.
1.5.3	Masa: Forcimi i rolit të enteve rregullatore në parandalimin e korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.5.1 Rritja e auditimeve në fushat me ndjeshmëri publike për të nxitur përdorimin efektiv të fondeve publike, forcimin e llogaridhënies dhe integritetit të administratës.	Forcimi i efektivitetit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, sidhe kontrolli financiar.	1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.	KLSH MF
Rezultati	1.5.2 Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga institucionet publike nga numri total i rekomandimeve të dhëna (trend rritës).	Forcimi i efektivitetit të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, sidhe kontrolli financiar.	1.5 Mbrojtja e financave dhe asetëve publike nga keqpërdorimi gjatë ushtrimit të funksionit publik.	MF KLSH

Objektivi Specifik 1.6: Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Sinjalizimi luan një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe zbulimin e korrupsionit, pasi mundësia e raportimit të tij ndikon në shmangien e keqpërdorimit të pushtetit nga nëpunësit publikë të zgjedhur dhe të emëruar. Shqipëria ka hartuar dhe miratuar kornizën ligjore që rregullon sinjalizimin, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e autoriteteve publike dhe subjekteve private, për të ngritur dhe bërë plotësisht funksionale këto struktura ose njësi. Duke e adresuar në mënyrë të dedikuar në një objektiv specifik sinjalizimin, strategjia synon të përmirësojë kuadrin ligjor për sinjalizimin përmes rishikimit të tij me qëllim përmirësimin e mbrojtjes ligjore të parashikuar për sinjalizuesit si dhe përditësimin e legjislacionit të vendit me zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian.¹⁵

Kuadri ligjor në fuqi për sinjalizimin ka të parashikuar organizimin dhe funksionimin e njësive të sinjalizimit dhe procedurat për ushtrimin e këtij mekanizmi. Përmirësimi i mëtejshëm i arritjeve në këtë fushë do të mundësohet përmes rishikimit të legjislacionit me synim harmonizimin me Direktivën (BE) 2019/1937. Ky proces do të shoqërohet edhe me miratimin e akteve nënligjore që do të rezultojnë si pasojë e përafrimit të ligjit kuadër për sinjalizimin, brenda vitit 2025. Përafrimi i ligjit me Direktivën do të garantojë mbrojtje më efektive për ata që raportojnë veprimet e supozuara korruptive. Përafrimi i ligjit me Direktivën do të garantojë mbrojtje më efektive për njerëzit që raportojnë veprat e korrupsionit. Ky fakt do të inkurajojë

¹⁵ Direktiva (BE) 2019/1937 e datës 23 tetor 2019 "Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkeljet e ligjit të Bashkimit".

qytetarët që të raportojnë në mënyrë proaktive veprat korruptive, duke kontribuar kështu në përmirësimin e efektivitetit të hetimeve kundër korrupsionit. Përmirësimi i rrjetit të sinjalizimit do të rrisë besueshmërinë dhe llogaridhënien, duke mundësuar një trajtim më të shpejtë dhe më të saktë të rasteve të raportuara.

Forcimi i të drejtave dhe mbrojtjes së sinjalizuesve duhet të zhvillohet paralelisht me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit publik. Këto fushata mund të kontribuojnë më tej në arritjen e qëllimit kryesor: krijimi i një mjedisi pune ku korrupsioni identifikohet dhe raportohet që në fazat e hershme të abuzimit. Kjo qasje ndihmon në zbutjen dhe frenimin e efekteve të korrupsionit në shoqëri, duke forcuar transparencën dhe llogaridhënien në sektorin publik dhe privat. Krijimi i një mjedisi të tillë, ku sinjalizimi është inkurajuar dhe mbrojtur, është një hap i rëndësishëm drejt parandalimit efektiv të korrupsionit.

Njëkohësisht me përmirësimin ligjor, kuadri institucional për sinjalizimin do të forcohet bazuar në vlerësimin e rrjetit të personave përgjegjës për marrjen e denoncimeve dhe raporteve të korrupsionit, pozicionin e tyre, mënyrën e komunikimit, bashkëpunimin dhe raportimin. Gjetjet do të përdoren për iniciimin dhe nxitjen e krijimit të mënyrave për raportimin e korrupsionit në institucionet që e kanë këtë detyrim ligjor, por që ende nuk kanë caktuar persona përgjegjës për marrjen e denoncimeve dhe raportimeve të korrupsionit, apo ku ndryshimi i tyre është i shpeshtë. Për më tepër, aftësimi profesional i këtyre personave do të forcohet përmes trajnimeve të shoqëruara me përmirësimin e shkëmbimit të informacionit mbi denoncimet dhe raportimin e korrupsionit midis ILDKPKI dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.

Gjithashtu, instrumentet për raportimin e korrupsionit dhe inkurajimin e gjerë të shoqërisë për të raportuar korrupsionin do të përmirësohen bazuar në vlerësimin e instrumenteve ekzistuese për të denoncuar dhe raportuar korrupsionin në institucionet e të gjitha niveleve.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.6 synon të përmirësojë më tej kuadrin ligjor për antikorrupsionin përmes harmonizimit të mëtejshëm të acquis-së së BE-së për përdorimin me efikasitet të mekanizmit të sinjalizimit, me synim final parandalimin e korrupsionit.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Përafrimi i legjislacionit për sinjalizimin me Direktivën e Bashkimit Evropian për sinjalizimin.

Rezultati 2: Rritja e informimit të qytetarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore mbi sinjalizimin.

Institucione Kryesore: Këshilli i Ministrave, Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Institucione Kontributore: Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 1.6: Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit
1.6.1	Masa: Forcimi i kuadrit ligjor për sinjalizimin.
1.6.2	Masa: Forcimi i kuadrit institucional për sinjalizimin.
1.6.3	Masa: Përmirësimi i mjeteve për raportimin e korrupsionit dhe inkurajimi për raportimin e korrupsionit.
1.6.4	Masa: Përmirësimi i mbrojtjes për individët që raportojnë korrupsionin

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkaptullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.6.1 Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, të miratuara, nga ato që janë planifikuar të miratohen (trend rritës).	Rritja e kontributit të sinjalizimit si një mjet për ndërtimin e integritetit dhe antikorrupsion.	1.6 Forcimi i kornizës së sinjalizuesve për zbulimin e hershëm të korrupsionit.	Kuvendi KM

Objektivi Specifik 1.7: Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike

Analiza e situatës dhe sfidat

Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike është një element thelbësor për sundimin e ligjit dhe parandalimin e korrupsionit, për shkak të shkallës së lartë të pjesëmarrjes së partive politike në të gjitha proceset vendimmarrëse. Shqipëria ka përparuar në vitet e fundit në drejtim të forcimit të transparencës financiare dhe integritetit të partive politike falë përmirësimit të kuadrit ligjor për financimin e partive politike dhe detyrimit që ato kanë për të deklaruar publikisht burimet e financimit dhe shpenzimet.

Në nëntor të vitit 2020, Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin për Partitë Politike duke mundësuar që ky akt të jetë në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor. Këto ndryshime ndihmuan në rregullimin e financimit publik të partive politike, trajtimit të donacioneve private dhe huave, si dhe ndalimin e përdorimit të burimeve publike për subjektet zgjedhore. Ligji gjithashtu përcakton procedurat për raportimin, publikimin, auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës, si dhe sanksionet në rast shkeljeje. Komisioni Evropian vlerësoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për përpjekjet e tij në fuqizimin e rolit mbikëqyrës për financimin e fushatave zgjedhore, në përputhje me rekomandimet e ODIHR-it.

Masat e marra për kontrollet e financave të partive politike kanë kontribuar në uljen e ndikimit të kontributeve të panjohura, të pidentifikuara dhe ndonjëherë edhe të paligjshme në financimin e partive politike. Këto masa kanë përmirësuar transparencën dhe kanë rritur përgjegjshmërinë e partive politike në raport me burimet e tyre financiare. Ky informacion është gjithashtu i aksesueshëm dhe në dispozicion të publikut ¹⁷ për të gjitha partitë politike, në faqen zyrtare të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Strategjia synon të ofrojë një perspektivë më të gjerë për mekanizmat e kontrollit, raportimin financiar, ndjekjen dhe identifikimin e donatorëve dhe të shpenzimeve, si dhe aksesin e qytetarëve në informacion mbi financat e partive politike, duke respektuar dhe detyrimet që burojnë nga Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës për miratimin e Ligjit për Financimin e partive politike brenda vitit 2027.

Me qëllim avancimin e mëtejshëm në forcimin e transparencës financiare të partive politike, parashikohet të ndërhyhet edhe në zbatimin rigoroz të rregulloreve ekzistuese, si dhe të normohen dhe zbatohen sanksione më të forta, monitorim i shtuar, si dhe auditim më gjithëpërfshirës i financave të partive politike. Këto masa synojnë të parandalojnë korrupsionin dhe pastrimin e parave, duke rritur llogaridhënien dhe transparencën e partive në lidhje me burimet e tyre financiare.

Ndërhyrjet synojnë të kontrollojnë dhe kufizojnë ndikimin e burimeve financiare dhe njerëzore të administratës publike gjatë fushatave zgjedhore dhe periudhave zgjedhore, duke siguruar që ato të mbahen larg ndikimeve politike. Këto masa janë të domosdoshme për të ruajtur integritetin e procesit zgjedhor dhe për të garantuar se administrata publike nuk përdoret për qëllime elektorale, duke kontribuar kështu në zhvillimin e një demokracie më të fortë dhe më transparente.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.7 synon të rrisë kontrollin e financave të partive politike, për të gjitha burimet e tyre financiare, për të garantuar pastërtinë e figurës dhe promovimin e integritetit personal dhe politik në jetën politike në vend, të personave me vlera qytetare, të arsimuara dhe me kontribute në jetën publike.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Forcimi i transparencës dhe kontrollit të burimeve të financimit të partive politike.

Rezultati 2: Rritja e besimit të qytetarëve te partitë politike.

Institucione Kryesore: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Institucione Kontributore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Organizata të Shoqërisë Civile.

Masat dhe aktivitetet

Ky objektiv specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

¹⁷ Raportet financiare të partive politike dhe ato të auditimeve të kryera për to gjenden të publikuara në faqe: <https://fpp.kqz.gov.al/kreu/reports>.

	Objektivi Specifik 1.7: Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike
1.7.1	Masa: Forcimi i transparencës financiare të partive politike.
1.7.2	Masa: Promovimi i rëndësisë së transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkaptullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.7.1 Hartimi i draftit të Ligjit për Financimin e Partive Politike.	Partitë politike të mundësojnë transparencë dhe kontroll të burimeve të financimit.	1.7 Forcimi i transparencës financiare dhe integritetit të partive politike.	KSHZ

Objektivi Specifik 1.8: Ngritja e kuadrit ligjor dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni

Analiza e situatës dhe sfidat

Me qëllim forcimin e besimit të publikut te institucionet e administratës publike, vendimmarrja gjatë ushtrimit të funksioneve në të gjitha fazat e saj duhet të jetë sa më transparente. Qytetarëve duhet t'u garantohet e drejta për t'u informuar rreth aktorëve që kanë akses dhe ushtrojnë ndikim mbi vendimmarrjen qeveritare. Transparenca në këtë aspekt është thelbësore për të ruajtur besimin publik ndaj institucioneve shtetërore. Në të kundërt, nëse forma të tilla ndikimi ushtrohen pa transparencë dhe llogaridhënie të plotë, mund të krijohen dyshime te publiku, duke dëmtuar demokracinë dhe integritetin e procesit vendimmarrës.

Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa paraprakë për të formësuar një kuadër nënligjor dhe institucional për lobimin, duke synuar rritjen e transparencës dhe garantimin e integritetit të zyrtarëve publikë dhe politikë në marrëdhëniet e tyre me lobistët dhe grupet e interesit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Avancimi i këtyre ndërhyrjeve përmes parashikimit të instalimit të instrumentit të lobimit dhe krijimit të një kuadri të posaçëm ligjor do të ndihmojë në kufizimin e konflikteve të interesit dhe në garantimin e deklaramit të aktiviteteve të zyrtarëve. Ky kuadër ligjor do t'u japë autoriteteve përgjegjëse mundësinë për të mbikëqyrur dhe monitoruar me vigjilencë aktivitetet, takimet dhe komunikimet e zyrtarëve me lobistët. Kjo qasje synon zbulimin dhe parandalimin e rasteve të korrupsionit, duke siguruar që ndërveprimet midis zyrtarëve publikë dhe lobistëve të jenë transparente dhe të rregulluara sipas ligjit.

Në Raportin e Zbatueshmërisë të Raundit V të Vlerësimit për Shqipërinë, të miratuar nga GRECO në datë 2 dhjetor 2022, rekomandohet që Shqipëria ta formalizojë instrumentin e lobimit dhe që anëtarët e Qeverisë të angazhohen në publikimin e kontakteve të tyre me lobistët dhe palët e treta të zhvilluara përmes mënyrave të ndryshme të komunikimit (e-mail, telefonata dhe mesazhet).

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, bazuar në Vendimin nr. 61/2018, datë 05.04.2018 "Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë", në zbatim të nenit 22, ka krijuar një regjistër të posaçëm për lobimin, grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile që mbajnë marrëdhënie me deputetët dhe komisionet parlamentare. Ky regjistër synon të rrisë transparencën dhe të përfshijë publikun në procesin legjislativ, duke lehtësuar ndërveprimin e qeverisë me aktorët e ndryshëm të shoqërisë dhe duke siguruar që këto marrëdhënie të jenë të hapura dhe të ndershme.

Parandalimi i korrupsionit përmes rregullimit të lobimit do të forcohet nëpërmjet krijimit të një kuadri të dedikuar ligjor dhe ngritjes së strukturave institucionale të specializuara për zbatimin e tij. Kjo do të përfshijë krijimin e një organi ose institucioni të ri përgjegjës për monitorimin e lobimit, me kompetenca të qarta dhe procedura të përcaktuara mirë. Ky organ do të sigurojë që aktivitetet e lobimit të jenë transparente, të monitoruara dhe të raportuara në përputhje me ligjin.

Hartimi i këtij kuadri ligjor do të bazohet në një shqyrtim të thelluar të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira për lobimin transparent, duke marrë parasysh rekomandimet nga organizatat ndërkombëtare që operojnë në këtë fushë. Këto rekomandime do të ndihmojnë në ndërtimin e një sistemi të besueshëm që siguron rregullimin e drejtë të lobimit, duke ndihmuar në parandalimin e korrupsionit dhe garantimin e integritetit në vendimmarrjen publike.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.8 synon parandalimin e korrupsionit përmes rregullimit të lobimit me krijimin e kuadrit të dedikuar ligjor.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Ngritja dhe funksionimi efikas i kuadrit ligjor për lobimin, në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Institucione Kryesore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Institucionet zbatuese të SNKK.

Institucione Kontributore: Këshilli i Ministrave, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Masat dhe aktivitetet

Ky objektiv specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 1.8: Ngritja e kuadrit ligjor dhe institucional për lobimin si instrument parandalimi korrupsioni
1.8.1	Masa: Krijimi i kornizës legjislative dhe institucionale për lobim.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.8.1 Raporti i numrit të akteve ligjore dhe nënligjore për lobimin të hartuara nga numri i atyre të planifikuara për miratim (trendi rritës).	Lobim transparent, i përgjegjshëm dhe i verifikueshëm për publikun.	1.8 Ngritja e kuadrit legjislativ dhe institucional për lobimin si instrument për parandalimin e korrupsioni.	KSHZ

Objektivi Specifik 1.9: Promovimi i integritetit në sektorin privat

Analiza e situatës dhe sfidat

Sektori privat luan një rol të rëndësishëm në parandalimin e korrupsionit, veçanërisht për shkak të ndikimit të tij potencial në marrëdhëniet që mund të krijojnë situata korruptive. Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka adoptuar një qasje bashkëpunuese horizontale me sektorin privat, duke përfshirë përfaqësuesit e tij në tryeza dhe forume me karakter informativ. Këto takime kanë shërbyer si një platformë për diskutimin e masave antikorrupsion dhe promovimin e integritetit në sektorin privat. Përveç kësaj, janë zhvilluar takime gjithëpërfshirëse dhe periodike për ndarjen e amendamenteve teknike të sektorit privat me strukturat e administratës publike, në funksion të forcimit të luftës kundër korrupsionit dhe rritjes së integritetit.

Në një ekonomi tregu të lirë, biznesi privat është motori i zhvillimit, kështu që sigurimi i klimës së duhur të biznesit është thelbësor në rregullimin e tregut. Duke njohur rëndësinë e prezencës së këtij sektori në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike që ndikojnë edhe në parimet e një qeverisjeje demokratike, parandalimi i korrupsionit kërkon ndërhyrje edhe në këtë sektor.

Integriteti në sektorin privat është thelbësor për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe konkurrueshmërinë e tregut. Kompanitë që veprojnë me integritet ndërtojnë besim te klientët, partnerët dhe investitorët, duke forcuar kështu reputacionin e tyre në treg dhe përmirësuar performancën financiare. Për të forcuar integritetin në sektorin privat, është thelbësore zbatimi i politikave të etikës së biznesit, garantimi i transparencës në menaxhimin financiar dhe krijimi i një kulture korporative që promovon ndershmërinë dhe përgjegjësinë. Me këtë qasje, bizneset jo vetëm që ndërtojnë besim te klientët, partnerët dhe investitorët, por gjithashtu kontribuojnë në mënyrë të ndjeshme në parandalimin e korrupsionit dhe abuzimeve me detyrën.

Lufta kundër ryshfetit dhe praktikave të tjera korruptive është gjithashtu jetike për mbrojtjen e sipërmarrësve dhe aktorëve të biznesit, taksapaguesve dhe të subjekteve që preken në mënyrë të tërthortë nga transaksionet e biznesit. Promovimi i integritetit në sektorin privat ¹⁸ do të realizohet në bashkëpunim me dhomat e tregtisë në vend dhe shoqatat e tyre, të cilat kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta me bizneset, me qëllim identifikimin e sfidave dhe pengesave përkatëse për rritjen e integritetit në sektorin privat, si dhe mënyrave për t'i kapërcyer ato. Përkëtë qëllim, si dhe për të promovuar zgjidhjet për kapërcimin e sfidave të identifikuar, do të organizohen aktivitete publike në mënyrë sistematike që theksojnë nevojën për integritet në sektorin privat. Njëherësh, modeli i Kodit të Etikës dhe Planit të Integritetit për kompanitë private do të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me dhomat e tregtisë dhe me kompanitë e mëdha që tashmë kanë ngritur dhe zbatojnë mekanizma të integritetit.

Në disa sektorë, korrupsioni në sektorin privat paraqet një rrezik të vërtetë dhe kërkon vëmendje të shtuar. Transaksionet abusive ndërmjet subjekteve private jo vetëm që ndikojnë në këto biznese individuale, por prekin të gjithë zinxhirin e furnizimit, duke deformuar tregjet, minuar konkurrencën e ndershme dhe rritur kostot për kompanitë. Këto praktika minojnë standardet e përgjithshme të biznesit, duke ulur nivelin e transparencës në transaksionet ekonomike dhe duke dëmtuar besimin e përgjithshëm të aktorëve ekonomikë te tregjet. Korrupsioni në sektorin privat ka ndikime të mëdha mbi aftësinë e tregjeve për të tërhequr investime të huaja dhe për të ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme me partnerë ndërkombëtarë. Ai kufizon mundësitë e tregjeve për të funksionuar në mënyrë të hapur dhe të drejtë, duke i bërë më pak tërheqëse për investitorët që kërkojnë stabilitet dhe qeverisje të mirë.

Për këtë arsye, zbatimi i mekanizmave të fortë kundër korrupsionit në sektorin privat është thelbësor për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Këto mekanizma ndihmojnë në ruajtjen e standardeve të integritetit dhe transparencës, duke siguruar që tregjet të funksionojnë me drejtësi dhe besueshmëri për të gjithë aktorët ekonomikë. Një mjedis i tillë rrit atraktivitetin e tregjeve për investimet e huaja dhe krijon një platformë të fortë për marrëdhënie të qëndrueshme me partnerë ndërkombëtarë.

Përkufizimi i OECD-së për fushat kyçe për sektorin privat, si qeverisja e korporatave, antikorrupsioni, përgjegjësia sociale, digjitalizimi dhe inovacioni, ofron udhëzime të rëndësishme për garantimin e efikasitetit të përpjekjeve antikorrupsion në këtë fushë. Dispozitat e Konventës së OECD-së "Për luftën kundër ryshfetit të zyrtarëve të huaj në transaksionet ndërkombëtare të biznesit" janë krijuar për të luftuar korrupsionin në transaksionet ndërkombëtare të biznesit, duke synuar përmirësimin e integritetit në operacionet ndërkufitare të sektorit privat. Përmirësimi i transparencës në prokurimet publike është një komponent thelbësor për reduktimin e rreziqeve të korrupsionit, duke ndihmuar që bizneset të ndërgjegjësohen për rëndësinë e rritjes së integritetit dhe zhvillimit të programeve të brendshme për parandalimin e korrupsionit. Në këtë kontekst, sektorët privatë po inkurajohen vazhdimisht që të adoptojnë politika të qarta për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit, të përmirësojnë sistemet e raportimit të abuzimeve dhe të ndërmarrin masa për raportimin e çdo veprimtarie të dyshimtë. Këto përpjekje janë në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe ofrojnë një rrugë të qartë për rritjen e përgjegjësisë dhe ndershmërisë në sektorin privat,

¹⁸ Një nxitje në parashikim që vjen edhe nga UNCAC (Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit) e cila e parashikon korrupsionin si në sektorin privat, ashtu edhe në sektorin publik. Iniciativa të tjera ndërkombëtare që ofrojnë udhëzime për etikën në biznes, si: Forumi Ekonomik Botëror, Transparency International, OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik), dhe G20.

duke krijuar një mjedis biznesi më të qëndrueshëm dhe të besueshëm, i cili është i mbrojtur ndaj praktikave korruptive.

Nëpërmjet koordinimit të fushatave të sensibilizimit, qeveria jo vetëm që i bën qytetarët dhe bizneset më të vetëdijshëm për rreziqet e korrupsionit, por gjithashtu krijon një mjedis të favorshëm për zhvillimin e politikave të qëndrueshme kundër korrupsionit. Aksionet kolektive, të cilat përfshijnë bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile dhe sektorin privat, janë jetike për të ndërtuar një infrastrukturë të fortë të integritetit dhe përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 1.9 sjell një qasje inovative në kuadrin strategjik antikorrupsion për vitet në vijim, duke përfshirë masa dhe mekanizma të rinj që synojnë përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies edhe në sektorin privat. Sektori privat luan një rol të rëndësishëm në programimin strategjik të vendit, duke kontribuar në standardizimin e ndërhyrjeve dhe veprimeve në përputhje me kuadrin rregullator ndërkombëtar.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Identifikimi i nevojës për integritet të shtuar dhe për vlerësime të rrezikut të korrupsionit në sektorin privat.

Rezultati 2: Fuqizim i kapaciteteve profesionale për bashkëpunim në analiza dhe kërkime mbi korrupsionin në sektorin privat.

Institucione Kryesore: Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Autoriteti i Konkurrencës, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Institucione Kontributore: Dhomat e Tregtisë dhe Biznesit, Dhomat e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Trajnimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Masat dhe aktivitetet

Ky objektiv specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 1.9: Promovimi i integritetit në sektorin privat
1.9.1	Masa: Promovimi i kërkesës për integritet në sektorin privat.
1.9.2	Masa: Parandalimi i korrupsionit në sektorët privatë me rrezik/prevalencë të lartë të korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkaptullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	1.9.1 Përqindja e subjekteve të sektorit privat me të cilat institucionet publike kanë vendosur bashkëpunime për ngritjen dhe promovimin e integritetit në sektorin privat nga numri i bashkëpunimeve të vendosura vitin e kaluar (trend rritës).	Përditësimi mbi rregullimin e integritetit dhe rreziqet e korrupsionit në sektorin privat të kryhet rregullisht.	1.9 Promovimi i integritetit në sektorin privat.	KKKK MEKI MF

QËLLIMI I DYTË I POLITIKËS: "NDËSHKIMI I KORRUPSIONIT" - Përbën shtyllën e dytë të SNKK 2024-2030 dhe përfshin 3 Objektivat Specifikë. Ky Qëllim do të fokusohet në reformimin e kuadrit ligjor dhe institucional, përmes aplikimit të një qasjeje represive për të maksimizuar ndikimin në luftën kundër korrupsionit. Disa nga ndërhyrjet e parashikuara në këtë kontekst, lidhen me hetimin administrativ, hetimin penal, bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, si dhe ngritjen dhe funksionimin e rrjeteve të komunikimit për forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe mundësimin e një historiku solid (track record) të hetimit.

Për këtë qëllim të strategjisë, Qeveria Shqiptare, nëpërmjet autoriteteve përgjegjëse në nivel administrativ, organeve ligjzbatuese dhe institucioneve të pushtetit gjyqësor, do të zbatojë ndërhyrje të dedikuara për të përmbushur objektivat antikorrupsion. Ato do të sigurojnë burimet e nevojshme për të garantuar zbatimin efektiv të masave dhe për të matur progresin në përmbushjen e qëllimeve strategjike.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të këtyre masave do të bazohet në një analizë periodike, e cila do të kryhet çdo gjashtë muaj dhe çdo vit, duke synuar evidentimin e progresit dhe sfidave në zbatimin e masave të parashikuara. Të dhënat e mbledhura nga këto analiza do të ndihmojnë në përshtatjen dhe përmirësimin e strategjisë gjatë fazës së saj të zbatimit, duke garantuar që objektivat të jenë të arritshme dhe të matshme në mënyrë të vazhdueshme.

Ky qëllim politik (II) synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

Objektivi Specifik 2.1: Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve profesionale për hetimin efektiv administrativ të korrupsionit.

Objektivi Specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.

Objektivi Specifik 2.3: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i dytë i Politikës synon rritjen e performancës së të gjitha strukturave përgjegjëse për verifikimin dhe inspektimin administrativ, ndjekjen penale, hetimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit në sektorin publik. Politika e ndëshkimit synon krijimin e kushteve për një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe qasje në drejtësi për të gjithë, si dhe të kontribuojë në ngritjen e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Ky Qëllim Politike lidhet me objektivin 16 të OZHQ: *“Paqe, siguri dhe institucione të forta dhe të efektive”*.

Objektivi Specifik 2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Përveç parandalimit të korrupsionit, Shqipëria ka zhvilluar gradualisht në vitet e fundit një arkitekturë të mirë institucionale për të ndihmuar në identifikimin dhe verifikimin administrativ për qëllime ndëshkimi të çdo rasti korrupsioni të lidhur me aktivitetin e administratës publike.

Në tetor të vitit 2021, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 618, datë 20.10.2021,¹⁹ u krijua Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion. Kjo strukturë u themelua për të centralizuar hartimin e politikave antikorrupsion dhe për të koordinuar hetimin administrativ të rasteve të korrupsionit në organet e administratës publike, të cilat ofrojnë shërbime për qytetarët. Gjatë funksionimit të saj, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka adresuar rekomandime konkrete për institucionet publike, me qëllim përmirësimin e performancës institucionale dhe procesit të ofrimit të shërbimeve kah qytetarëve. Përveç kësaj, ajo ka marrë masa administrative dhe ka depozituar kallëzime penale pranë organeve të zbatimit të ligjit, në rastet ku është konstatuar përgjegjësi penale. Këto veprime synojnë forcimin e integritetit në administratën publike dhe parandalimin e rasteve të korrupsionit nëpërmjet një qasjeje të strukturuar dhe të qëndrueshme.

Gjithashtu, në muajin nëntor 2021, është miratuar ligji “Për Bashkëqeverisjen”, i cili ridimensionoi platformën “Shqipëria që duam”, ku nëpërmjet seksionit “Denonco korrupsionin”, të gjithë qytetarët që konstatojnë elemente të një akti korruptiv, mund t’i denoncojnë ato.

Ridimensionimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të forcuar koordinimin mes strukturave shërben maksimalisht në funksion të parandalimit të korrupsionit në administratën publike, duke synuar kryerjen e hetimeve efektive dhe të pavarura, të cilat janë thelbësore për parandalimin e veprave penale të korrupsionit nga punonjësit e administratës publike. Funkcioni kryesor i veprimtarisë së hetimit administrativ, është së pari, evidentimi i praktikave abuzive, me qëllim ndërmarrjen e masave me natyrë sistematike dhe jo sporadike. Bazuar në praktikën e deritanishme të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, synimi në periudhën në vijim do të jetë, adresimi i problematikave në efikasitetin institucionale të cilat bëhen shkak për hapësira korruptive.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 2.1 ridimensionon kuadrin e hetimeve administrative dhe ndjekjen e denoncimeve dhe ankesave nga strukturat e brendshme të marrjes së ankesave dhe rasteve korruptive, me qëllim orientimin e marrjes së masave me natyrë sistematike.

Rezultate të pritshme për këtë objektivi përmenden:

¹⁹ Ky Vendim i Këshillit të Ministrave është shfuqizuar pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 436, datë 26.06.2024 “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”.

Rezultati 1: Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve të strukturave të përfshira në verifikimin dhe hetimin administrativ të rasteve të korrupsionit në administratë.

Rezultati 2: Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit të organeve që kryejnë verifikimin dhe hetimin administrativ të korrupsionit.

Rezultati 3: Krijimi dhe konsolidimi i një sistemi që adreson në mënyrë sistematike rastet e hetimit administrativ të korrupsionit.

Institucione Kryesore: Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Institucione Kontributore: Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Agjencia për Dialog dhe Bashkqeverisje, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 2.1: Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit
2.1.1	Masa: Forcimi i kuadrit institucional dhe koordinimit për hetimin dhe verifikimin administrativ të korrupsionit.
2.1.2	Masa: Forcimi i kapaciteteve institucionale për hetimin dhe verifikimin administrativ të korrupsionit.
2.1.3	Masa: Rritja e performancës së strukturave përgjegjëse për hetimin dhe verifikimin administrativ të korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkaptullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	2.1.1 Përqindja e analizave në vijim të hetimeve administrativ me qëllim marrjen e masave sistematike (në rritje).	Forcimi i përgjithshëm i kapaciteteve të strukturave të përfshira në verifikimin dhe hetimin administrativ të rasteve të korrupsionit në administratë.	2.1 Forcimi i kuadrit legjislativ, institucional dhe kapaciteteve për hetim efektiv administrativ të korrupsionit.	DPAK

Objektivi Specifik 2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Lufta kundër korrupsionit kërkon një sistem drejtësie të pavarur dhe efikas, si dhe organe ligjzbatuese të pajisura me burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknologjike. Këto struktura duhet të kenë aftësinë për të përdorur mjetet digjitale në mënyrë efektive, për të siguruar zbatimin e legjisllacionit antikorrupsion, të mbështetur nga hetime dhe ndjekje penale të paanshme.

Shqipëria, gjatë viteve të fundit, ka treguar përparime të rëndësishme në këtë drejtim, duke demonstruar rezultate të qëndrueshme në hetimin dhe gjykimin e krimeve të korrupsionit. Vlerësimet ndërkombëtare kanë theksuar në mënyrë të veçantë rolin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), si dhe organeve të tjera ligjzbatuese, të cilat janë vlerësuar për ndjekjen penale efektive dhe gjykimin e suksesshëm të çështjeve të korrupsionit. Në këtë kuadër, evidentohet roli dhe aktiviteti i BKH si institucion kontribues përgjatë periudhës 2022 - 2023, me një total prej 17 referimesh për korrupsion në Prokurorinë e Posaçme.

Në vitet e fundit, organet e ndjekjes penale kanë përmirësuar ndjeshëm performancën e tyre nëpërmjet zbatimit të metodave të hetimit proaktiv, si përgjimet telefonike, si dhe metodave të posaçme, përfshirë vëzhgimet, simulimet, kontrollet, sekuestrimin e provave materiale, letërporositë dhe përdorimin e agjentëve të infiltruar. Prokuroria e Posaçme (SPAK) regjistroi një rritje të aktivitetit prej 16% gjatë vitit 2023, duke regjistruar 67 procedime penale, krahasuar me 28 procedime të regjistruara në vitin 2022. Në total, janë hetuar 447 çështje të lidhura me korrupsionin, nga të cilat 38 janë dërguar për gjykim.

Gjatë vitit, metodat e hetimit proaktiv janë përdorur intensivisht, përfshirë përgjimet dhe veprimet e posaçme si vëzhgimet dhe simulimet. Përgjimet janë aplikuar në 186 procedime, një rritje e ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar. Po ashtu, organet e tjera raportuan rritje të dukshme në ndjekjen dhe ndëshkimin e veprave penale të korrupsionit. Policia e Shtetit identifikoi gjithsej 443 vepra penale, me një shkallë zbulueshmërie prej 84.19%. Sa i përket veprave penale të korrupsionit, janë evidentuar 194 raste, nga të cilat 167 janë zbuluar, duke shënuar një shkallë zbulueshmërie prej 86.8%. Gjithashtu, janë zhvilluar 20 procedime penale ndaj zyrtarëve të lartë, duke përfshirë 22 persona të cilët janë nën hetim ose në proces gjyqësor.²⁰

Prokuroria e Posaçme (SPAK), gjatë viteve 2021 dhe 2022, ka sekuestruar dhe konfiskuar përkatesisht 21 milionë euro dhe 31 milionë euro pasuri të përfituara nga aktivitete kriminale. Në vitin 2023, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në gjykatë 8 kërkesa për sekuestrimin e vlerave monetare, subjekteve tregtare, pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, nga të cilat 7 janë miratuar nga gjykata, duke përfshirë pasuri të vlerësuara në rreth 275,553,016 lekë. Njëkohësisht, janë paraqitur 6 kërkesa për konfiskim, të cilat janë pranuar nga gjykata, me një vlerë totale prej 64,341,850 lekë.²¹

Zbatimi i sanksioneve efektive, proporcionale dhe të ligjshme për korrupsionin, si dhe rikuperimi dhe konfiskimi i të ardhurave të përfituara nga këto aktivitete kriminale,

²⁰ Raporti vjetor 2023, i monitorimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023.

²¹ Raporti vjetor i SPAK, 2023

kontribuojnë në rritjen e besueshmërisë së drejtësisë dhe zbatimit të ligjit, duke shërbyer njëkohësisht si një masë parandaluese për krimet e ardhshme. Ndërhyrja strategjike synon përmirësimin e kapaciteteve, burimeve dhe performancës, për të rritur efikasitetin në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit. Ky plan synon përmirësimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë, duke lehtësuar zbulimin, hetimin dhe ndëshkimin e çdo aktiviteti të paligjshëm në këtë fushë. Përmirësimi i kapaciteteve profesionale do t'u mundësojë organeve të zbatimit të ligjit të kryejnë hetime sipas standardeve më të larta të përcaktuara nga legjislacioni penal dhe konventat ndërkombëtare, si dhe të sigurojnë prova të mjaftueshme për ndjekjen penale të personave të përfshirë në korrupsion.

Qëllimi për të forcuar kapacitetet, burimet dhe performancën në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit është thelbësor për procesin e integritetit evropian të Shqipërisë, duke pasur parasysh rëndësinë e rritjes së integritetit të institucioneve vendase dhe demonstrimin e aftësive të tyre në luftën kundër korrupsionit. Si një kërkesë kyçe e këtij procesi, është e domosdoshme të sigurohet fuqizimi i sistemit të drejtësisë, në mënyrë që ai të jetë i aftë për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e korrupsionit, veçanërisht ato të nivelit të lartë. Në këtë kontekst, SPAK, përfshirë strukturat profesionale-teknike të saj që kanë kompetenca hetimore si Byroja Kombëtare e Hetimit luajnë një rol kryesor. Arritja e këtij qëllimi do të konsolidojë jo vetëm besueshmërinë e sistemit të drejtësisë, por edhe avancimin e Shqipërisë në rrugën e saj drejt integritetit në Bashkimin Evropian.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 2.2 ka një rëndësi të veçantë brenda kuadrit strategjik ndërsektorial kundër korrupsionit në fushën e zbatimit të ligjit, pasi synon garantimin e vendosjes së sanksioneve efektive dhe proporcionale nga autoritetet kompetente ndaj veprave penale të korrupsionit.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit.

Rezultati 2: Forcimi i kapaciteteve profesionale të autoriteteve ligjzbatuese në menaxhimin dhe përdorimin e njohurive për hetimin penal të korrupsionit dhe rasteve të korrupsionit në sektorë të tjerë.

Rezultati 3: Rritja e cilësisë së hetimit efektiv penal, ndjekjes penale dhe sanksionimi i krimit të korrupsionit.

Rezultati 4: Rritja e numrit të operacioneve antikorrupsion me përdorimin e teknikave speciale hetimore dhe proaktive.

Institucione Kryesore: Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Ministrave, Kuvendi, Ministria e Brendshme, SPAK, Policia e Shtetit, Akademia e Sigurisë, Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Shkolla e Magjistraturës, Byroja Kombëtare e Hetimit, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Agjencia e Inteligjencës Financiare.

Institucione Kontributore: Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë Prokurorisë, Shkolla e Magjistraturës, SPAK, Prokuroria e Përgjithshme, Akademia e Sigurisë, Byroja Kombëtare e Hetimit, Policia e Shtetit.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit
2.2.1	Masa: Forcimi i kornizës legislative për sigurimin e një veprimtarive eficiente të hetimit e ndëshkimit penal të korrupsionit.
2.2.2	Masa: Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale të organeve ligjzbatuese dhe stafeve pranë tyre, me fokus hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit.
2.2.3	Masa: Konsolidimi i qëndrueshëm i strukturave të agjencive ligjzbatuese për të siguruar hetime proaktive kundër korrupsionit (përmirësim i performancës).
2.2.4	Masa: Rritja e performancës së agjencive ligjzbatuese për hetimin penal të korrupsionit nëpërmjet bashkëpunimit institucional, komunikimit me publikun dhe administrimit të informacionit statistikor.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të acquis-së së BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	2.2.1 Përqindja e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara për hetimin penal të korrupsionit nga ato të planifikuara për t'u miratuar.	Rritja e cilësisë së hetimit efektiv penal, ndjekjes penale dhe sanksionimi i krimit të korrupsionit.	2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.	Kuvendi KM
Rezultati	2.2.2 Raporti i hetimeve penale të përfunduara për korrupsion nga hetimet ende në vijim (zvogëlimi i back-logut) (trend rritës).	Rritja e cilësisë së hetimit penal, ndjekjes penale dhe sanksionimi i krimit të korrupsionit.	2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës në hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit.	KKKK
Rezultati	2.2.3 Përqindja e vlerës së pasurive të sekuestruara si rezultat i hetimit të rasteve të korrupsionit nga vlera mesatare e pasurive të sekuestruara në tre vitet e fundit (trend rritës).	Rritja e cilësisë së hetimit efektiv penal, ndjekjes penale dhe sanksionimi i krimit të korrupsionit.	2.2 Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit.	SPAK AAPSK

Objektivi Specifik 2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimin ekonomik dhe pastrimit të parave

Analiza e situatës dhe sfidat

Korrupsioni nuk mund të luftohet në mënyrë të izoluar. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave, si dhe dialogu i vazhdueshëm ndërmjet shteteve dhe institucioneve të tyre ligjzbatuese, përmes rrjeteve të bashkëpunimit mbi zhvillimin dhe zbatimin e reformave dhe masave për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit, janë elemente thelbësore për një luftë efektive kundër këtij fenomeni.

Bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet agjencive ligjzbatuese dhe institucioneve të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit, përfshirë krimin ekonomik dhe pastrimin e parave, ka një rëndësi kritike, duke pasur parasysh nevojën për të adresuar krimin transnacional. Krimi ekonomik mund të ketë ndikime të mëdha në stabilitetin financiar të vendit. Në këtë kontekst, bashkëpunimi ndërkombëtar mundëson shkëmbimin e informacionit për ndalimin në kohë dhe në mënyrë efektive të aktiviteteve kriminale në shkallë globale.

Shqipëria është një partner i rëndësishëm në bashkëpunimin ndërkombëtar, me një komunikim të shtuar të Prokurorisë së Posaçme (SPAK) me autoritetet homologe evropiane, amerikane, dhe ato të Amerikës Qendrore dhe Jugore. Këto komunikime të drejtpërdrejta janë rritur çdo vit. Shkëmbimi i shpeshtë i informacionit është realizuar edhe përmes rrjeteve si Eurojust, Interpol, Europol dhe me oficerët ndërlidhës të atashuar pranë ambasadave të huaja në Tiranë. Përmendim, specifikisht, që në vitin 2023, njësia hetimore pranë SPAK, BKH, ka realizuar në total 39 shkëmbime informacioni me DEA, Europol, Italinë, vendet nordike dhe me 10 shtete të tjera evropiane.

Të dhënat për dy vitet e fundit tregojnë se Policia e Shtetit ka realizuar 405 shkëmbime informacioni me Interpolin, 2740 korrespondenca me Europolin dhe 77 shkëmbime me rrjetin CARIN gjatë vitit 2022. Gjatë vitit 2023, janë realizuar 443 shkëmbime informacioni me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë 266 me Interpolin, 79 me Europolin dhe 88 me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Përmirësimi i mëtejshëm i performancës dhe rritja e rezultateve pozitive në fushën e krimin ekonomik dhe pastrimit të parave mbetet një prioritet.

Organet kombëtare të hetimit dhe ndjekjes penale, si Prokuroria e Posaçme (SPAK), Prokuroria e Përgjithshme dhe Policia e Shtetit, janë anëtare të Rrjetit GlobE - Rrjeti Operacional Global i Autoriteteve Ligjzbatuese, i krijuar nga UNODC për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar në rastet e korrupsionit. Ky rrjet ofron mundësi për trajtimin e rasteve dhe shkëmbimin e përvojave midis prokurorëve dhe oficerëve të policive gjyqësore. Për më tepër, krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, përmirësimi i databazave shtetërore për të cilat kanë akses organet ligjzbatuese dhe zgjidhja e sfidave në raportimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet policisë, prokurorisë dhe Agjencisë së Inteligjencës Financiare, janë zhvillime të rëndësishme në forcimin e hetimit penal.

Efektiviteti i veprimeve të ndërmarra për zbatimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit, si dhe mbështetja e përpjekjeve të vendeve partnere, varet nga reputacioni dhe profesionalizmi i institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese. Për të përmirësuar këto rezultate dhe për të rritur ndikimin e organeve ligjzbatuese, do të intensifikohen përpjekjet për të lehtësuar dhe koordinuar veprimet në forume shumëpalëshe, përveç angazhimit aktiv në konventën UNCAC.

Bashkëpunimi i ndërsjellë midis vendeve partnere, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve për zbulimin e rrjeteve kriminale, mund të përmirësojë rezultatet e Shqipërisë në drejtim të luftës kundër korrupsionit. Në këtë mënyrë, Shqipëria bëhet një partner më i besueshëm dhe më efektiv në rrjetin global të luftës kundër korrupsionit, duke kontribuar jo vetëm në përmirësimin e kontekstit kombëtar, por edhe në stabilitetin rajonal dhe përtej tij.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 2.3 angazhon organet ligjzbatuese në bashkëpunimin ndërkombëtar, duke pasur parasysh natyrën shpesh ndërkufitare të krimit të korrupsionit. Për të përmirësuar performancën e autoriteteve shqiptare në bashkëpunimin ndërmjet shteteve dhe me misionet e huaja, nevojiten kapacitete profesionale të përshtatshme dhe mjete të mjaftueshme.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Promovim i hetimeve efektive të korrupsionit dhe krimit ekonomik nga organet ligjzbatuese dhe ato gjyqësore shqiptare në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtare shumëpalëshe (EUROJUST, EUROPOL, CARIN, UNODC, GlobE, etj.).

Rezultati 2: Forcimi i kornizës dhe kapaciteteve për bashkëpunim dypalësh dhe shumëpalësh për hetimin e korrupsionit dhe krimit ekonomik.

Rezultati 3: Ofrimi i programeve të zhvillimit të aftësive të avancuara për agjencitë e zbatimit të ligjit dhe prokurorët për hetimin e korrupsionit dhe krimit ekonomik dhe financiar.

Institucione Kryesore: Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, SPAK, Prokuroria e Përgjithshme, Zyra e Rikuperimit të Aseteve, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Institucione Kontributore:

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 2.3: Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave
2.3.1	Masa: Përmirësimi dhe evidentimi i bashkëpunimit ndërkombëtar të organeve ligjzbatuese (të juridiksionit të posaçëm dhe ato të juridiksionit të zakonshëm), për hetimin dhe ndëshkimin e krimit të korrupsionit dhe të krimeve me natyrë ekonomike.
2.3.2	Masa: Vendosi e bashkëpunimit ndërkombëtar midis Zyrave të Rekuperimit të Aseteve për gjurmimin e informacionit për pasuri dhe asete të vëna nga krimi i korrupsionit dhe krimet me natyrë ekonomike.
2.3.3	Masa: Ngritja e kapaciteteve, shkëmbimi i informacionit dhe aktivitete të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e luftës kundër korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	2.3.1 Raporti i numrit të operacioneve të nisura nga Eurojust, Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë nga numri mesatar i këtyre operacioneve në tre vitet e kaluara (trend rritës).	Hetime efektive të korrupsionit dhe krimit ekonomik nga organet ligjzbatuese dhe gjyqësore shqiptare në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtare.	2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i agjencive ligjzbatuese dhe organeve gjyqësore në luftën kundër korrupsionit, krimit ekonomik dhe të pastrimit të parave.	PSH SPAK PP

QËLLIMI I TRETË I POLITIKËS: "NDËRGJEGJËSIMI DHE EDUKIMI KUNDËR KORRUPSIONIT"

- Shtylla e tretë e Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2024-2030 përmban katër Objektiva Specifikë dhe ka për qëllim promovimin e rolit edukues dhe aktivitetet sociale të grupeve të interesit në luftën kundër korrupsionit. Kjo shtyllë synon të mobilizojë të rinjtë, shoqërinë civile, sektorin privat dhe administratën publike si promotorë të luftës kundër korrupsionit, duke ndihmuar në ngritjen e kulturës së integritetit në veprimtaritë publike dhe në ofrimin e shërbimeve.

Për zbatimin e këtij qëllimi, Qeveria shqiptare dhe administrata publike synojnë të ndërtojnë partneritete të qëndrueshme dhe të integrojnë parimet e bashkëpunimit institucional dhe ndërinstucional midis aktorëve publikë dhe jo-publikë. Për të monitoruar progresin në zbatimin e masave të parashikuara, të dhënat përkatëse do të analizohen në mënyrë periodike, mbi baza 6-mujore dhe vjetore.

Ky qëllim politik (III) synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

Objektivi Specifik 3.1: Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin.

Objektivi Specifik 3.2: Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit.

Objektivi Specifik 3.3: Përfshirja e opinionit publik, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit.

Objektivi Specifik 3.4: Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm.

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i tretë i Politikës synon ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe edukimin e të rinjve, grupeve të interesit, publikut dhe shoqërisë së gjerë për t'u angazhuar në mënyrë proaktive në luftën kundër korrupsionit. Politika e edukimit dhe ndërgjegjësimit fokusohet në krijimin e partneriteteve dhe ndërmarrjen e veprimeve kolektive në përpjekjet për të luftuar korrupsionin.

Ky qëllim politik lidhet me objektivin 16 të OZHQ: "Paqe, siguri dhe institucione të forta dhe efektive".

Objektivi Specifik 3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin

Analiza e situatës dhe sfidat

Ndërgjegjësimi ndaj korrupsionit është një hap i rëndësishëm dhe një element strategjik kyç në avancimin e përpjekjeve kundër korrupsionit. Kur qytetarët janë të mirëinformuar mbi pasojat negative të korrupsionit, ata janë më të përgatitur për të kundërshtuar dhe raportuar rastet korruptive. Përmes informimit dhe ndërgjegjësimit, qytetarët fuqizohen si partnerë të rëndësishëm në përpjekjen e përbashkët për një shoqëri të drejtë, të udhëhequr nga parimet e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit. Kjo ndihmon në krijimin e një mjedisi motivues, që përmirëson transparencën dhe llogaridhënien në administratën publike dhe në institucionet shtetërore në përgjithësi.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë iniciativash për rritjen e ndërgjegjësimit kundër korrupsionit, ku Ministria e Drejtësisë, si Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit (deri në vitin 2023), ka investuar me prioritet në orientimin e vëmendjes së opinionit publik në këtë drejtim. Në periudhën 2022-2023, janë zhvilluar tre fushata vjetore ndërgjegjësuese, duke përfshirë promovimin e Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit përmes videove të shpërndara për publikun, bashkëpunimin me botën akademike, si dhe konsolidimin e traditës së mbajtjes së edicioneve të "Javës së Integritetit".

Gjatë vitit 2023, janë publikuar 15 video udhëzuese për të promovuar raportimin e korrupsionit dhe mekanizmat ekzistues për denoncimin e tij. Krahas këtyre aktiviteteve, edhe një sërë institucionesh të tjera kanë ndërmarrë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe aktivizimin e mekanizmave për raportimin e korrupsionit. Në kontekstin e integritetit evropian të Shqipërisë, përmirësimi i sundimit të ligjit dhe funksionimi efikas i administratës publike përbëjnë kërkesa thelbësore. Në këtë drejtim, rritja e ndërgjegjësimit kundër korrupsionit dhe promovimi i llogaridhënies janë faktorë kyç për përmbushjen e këtyre kërkesave dhe për avancimin e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.

Ndërgjegjësimi dhe informimi i vazhdueshëm për të nxitur denoncimin e rasteve të korrupsionit synon të promovojë vlerat e etikës dhe integritetit, si dhe ndihmon në zhvillimin e një kulture të ligjshmërisë që në gjenezë, përmes edukimit në institucionet arsimore. Ky proces është i rëndësishëm, pasi në këtë periudhë formësohet karakteri i fëmijëve dhe të rinjve.

Ndërgjegjësimi i të rinjve për rëndësinë e integritetit është jetik për ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe transparente. Të rinjtë, si e ardhmja e shoqërisë tonë, luajnë një rol vendimtar në formësimin e një kulture që promovon ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë në shoqëri. Kur të rinjtë janë të mirëinformuar dhe të ndërgjegjësuar për vlerat e integritetit, ata janë më të përgatitur për të identifikuar dhe kundërshtuar sjelljet joetike dhe korruptive. Kjo qasje ndihmon në krijimin e një mjedisi ku respektohen rregullat dhe ligjet, duke forcuar besimin e qytetarëve tek institucionet dhe duke kontribuar në një të ardhme ku transparenca dhe llogaridhënia mbeten parime themelore. Edukimi për integritetin, që në moshë të re, i pajis të rinjtë me aftësitë e nevojshme për të qenë qytetarë të përgjegjshëm dhe mbrojtës të parimeve të drejta në jetën e tyre shoqërore dhe profesionale.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, në bashkëpunim të ngushtë me partnerë nga sektori publik dhe aktorë të tjerë, do t'i japë përparësi fushatave ndërgjegjësuese dhe programeve të edukimit qytetar. Këto programe synojnë të theksojnë rolin thelbësor që çdo individ luan në promovimin e një kulture të integritetit,

duke nxitur përfshirjen aktive të qytetarëve në luftën kundër korrupsionit. Një nga elementët kryesorë të këtij angazhimi do të jetë eksplorimi i mënyrave se si pjesëmarrësit e këtyre programeve mund të veprojnë si “ambasadorë të integritetit,” duke u bërë shembuj të gjallë të praktikave të mira dhe duke shumëfishuar ndikimin pozitiv të këtyre përpjekjeve brenda komuniteteve të tyre.

Përveç kësaj, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit do të përqendrohet në hartimin e mundësive të reja për bashkëpunim në fushën e edukimit kundër korrupsionit. Këto përpjekje do të synojnë t'u ofrojnë qytetarëve dhe publikut të gjerë informacion më të qartë dhe të arritshëm për rëndësinë e luftës kundër korrupsionit, duke siguruar që mesazhet dhe përpjekjet e tyre të jenë të përputhura dhe të koordinuara me ato të mjeteve të informimit publik. Kjo qasje synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të krijojë një pozicionim më koherent për të fuqizuar qytetarët në luftën për transparencë dhe integritet.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 3.1 synon të nxisë qytetarët dhe publikun e gjerë për të raportuar në mënyrë të shpejtë dhe në kohë reale rastet e korrupsionit. Kjo qasje ndaj raportimit të rasteve korruptive shihet si një urë bashkëpunimi me administratën publike dhe një instrument aktiv për ndërtimin e institucioneve efikase.

Rezultate të pritshme për këtë objektiv përmenden:

Rezultati 1: Informimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mundësitë për përdorimin proaktiv të kanaleve të raportimit të korrupsionit.

Rezultati 2: Rritja e besimit të publikut të gjerë në luftën kundër korrupsionit.

Rezultati 3: Rritja e pjesëmarrjes qytetare dhe diskutimit publik mbi rrezikun e korrupsionit dhe integritetin.

Institucione Kryesore: Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Institucione Kontributore: Organizata të Shoqërisë Civile dhe media.

Masa dhe aktivitete

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi specifik 3.1: Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin
3.1.1	Masa: Rritja e ndërgjegjësimit dhe komunikimit të vazhdueshëm të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit në shoqëri.
3.1.2	Masa: Promovimi i mënyrave të raportimit të korrupsionit dhe inkurajimi i

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	3.1.1 Informim i shtuar i qytetarëve për mekanizmat veprues në luftën kundër korrupsionit.	Rritja e besimit të publikut të gjerë në luftën kundër korrupsionit.	3.1 Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit dhe nxitja e tyre për të kundërshtuar, denoncuar dhe raportuar korrupsionin.	KKKK

Objektivi Specifik 3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Synimi për të promovuar edukimin e të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit është rezultat i një qasjeje të kujdesshme, të ndjekur gjatë zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023 nga Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Ky synim ka rëndësi të veçantë për ndërgjegjësimin dhe përgatitjen e të rinjve, duke i bërë ata të kontribuojnë në mënyrë efektive në parandalimin dhe reduktimin e korrupsionit në shoqëri. Ndërmarrja e hapave të nevojshëm konsiderohet si një praktikë e suksesshme për përfshirjen e kurrikulave të përshtatshme në institucionet e arsimit parauniversitar, të cilat përfshijnë vlerat e etikës dhe integritetit.

Projekti pilot, i realizuar gjatë viteve 2020-2021 nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ambasada Italiane në Shqipëri, i fokusuar në zbatimin e një moduli edukativ antikorrupsion në 4 shkolla të arsimit të mesëm të lartë në Tiranë, synohet të shtrihet në të gjithë vendin. Ky projekt u riaplikua në vitin shkollor 2023-2024 në 12 shkolla të mesme dhe u vlerësua si një bazë solide për zhvillimin e mëtejshëm të kurrikulës për integritetin dhe antikorrupsionin. Projekti është një rezultat i suksesshëm i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me mbështetjen e Ambasadës së Italisë në Tiranë. Ky projekt do të vazhdojë edhe në vitet mësimore 2024-2025 dhe 2025-2026 në shkollat e mesme të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Vlorës, Korçës dhe Gjirokastrës.

Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit është ngushtësisht i lidhur me procesin e integritetit evropian të vendit dhe përfaqëson një angazhim të Shqipërisë për të avancuar në këtë drejtim. Përmes përgatitjes së një brezi të ri qytetarësh të ndërgjegjësuar për këto vlera, synohet të garantohet që të rinjtë dhe fëmijët të pajisen me informacionet e duhura dhe të përshtatshme për ta.

Krijimi i një kulture të tillë kërkon veprime të koordinuara në disa drejtime:

nga integrimi i etikës dhe integritetit në pritshmëritë e të rinjve përmes edukimit të tyre, deri tek lehtësimi i shkëmbimeve midis aktorëve në nivel kombëtar për të forcuar kuptimin e sfidave dhe për të nxitur angazhimin e tyre për të vepruar dhe reaguat. Kjo qasje synon gjithashtu të përcjellë frymën e mospranimit të korrupsionit tek familjet dhe komunitetet e tyre.

Në një perspektivë afatgjatë, synohet formimi i një brezi të ri qytetarësh të ndërgjegjësuar dhe të përgatitur për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie me integritet. Ky grup i synuar është pjesë e një strategjie më të gjerë për luftën kundër korrupsionit, e cila i kushton një rëndësi të veçantë brezit të ri si një faktor ndryshimi për të ardhmen e shoqërisë shqiptare. Zbatimi i kësaj qasjeje ka për qëllim krijimin e kushteve për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, përmes përfshirjes së të rinjve si pjesë aktive në përpjekjet për transparencë dhe llogaridhënie.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me Objektivin Specifik

Objektivi Specifik 3.2 fokusohet në nxitjen e të rinjve dhe grupeve të reja shoqërore për të konsoliduar sjelljen etike, integritetin dhe parimet e besueshmërisë në luftën kundër korrupsionit. Ndërhyrjet e planifikuara do të përqendrohen kryesisht në përmirësimin e kurrikulave arsimore, zhvillimin e bashkëpunimeve me median dhe realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit.

Masat do të zbatohen për të arritur këto rezultate:

Rezultati 1: Rishikimi i kurrikulës arsimore për të rinjtë, me synim edukimin për vlerat dhe sjelljet etike thelbësore që refuzojnë korrupsionin.

Rezultati 2: Ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi periodik kundër korrupsionit me pjesëmarrje aktive të të rinjve.

Institucione Kryesore: Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar).

Institucione Kontributore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Radio Televizioni Shqiptar, Media, Institucione të Arsimit të Lartë.

Masa dhe aktivitetet

Ky Objektiv Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 3.2: Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit
3.2.1	Masa: Forcimi i komponentit të etikës dhe integritetit në kurrikulat në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.
3.2.2	Masa: Forcimi i aspektit të etikës dhe integritetit në programet edukative të medias (TV dhe radio).
3.2.3	Masa: Promovimi i rëndësisë së angazhimit proaktiv të të rinjve në antikorrupsion. qytetarëve për ta denoncuar atë.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	3.2.1 Përqindja e shkollave në të cilat është zbatuar kurrikula e etikës nga mesatarja e shkollave ku këto kurrikula janë zbatuar në tre vitet e fundit (trend rritës).	Nivel më i lartë ndërgjegjësimi mbi etikën, integritetin, dhe luftën kundër korrupsionit.	3.2 Edukimi i të rinjve mbi etikën, integritetin dhe angazhimin proaktiv në luftën kundër korrupsionit.	KKKK

Objektivi Specifik 3.3 Përfshirja e të gjithë shoqërisë, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit

Analiza e situatës dhe sfidat

Lufta efektive kundër korrupsionit kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të shoqërisë. Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve akademike është thelbësore për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës, ku të gjitha palët të kontribuojnë në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Përfshirja e të gjitha sferave shoqërore, përmes organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fusha të ndryshme, është adresuar edhe në Strategjinë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2015-2023. Në këtë kuadër, AMSHC ka punuar drejt thirrjeve të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramimit të fondeve për këtë qëllim.

Duke bashkuar të gjithë aktorët, ky objektivi promovon një qasje të bashkërenduar midis tyre në luftën kundër korrupsionit, me synimin për të garantuar një shoqëri më të drejtë, më transparente dhe që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme. Përfshirja e kësaj qasjeje përfaqëson një risi në krahasim me strategjinë e mëparshme, duke marrë parasysh rëndësinë e kontributit të këtyre aktorëve në përmirësimin e institucioneve, zbatimin e ligjit dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Sektori privat ka një rol thelbësor në promovimin e transparencës, etikës dhe menaxhimit të rrezikut të korrupsionit në biznes, duke ndihmuar kështu në krijimin e një mjedisi që nxit konkurrencën e ndershme. Përdorimi i metodave të përbashkëta të komunikimit, nëpërmjet botimeve dhe mjeteve të cilat kanë interes dhe ndikim publik, do të përforcojë ndërveprimin ndërmjet nismave antikorrupsion të sektorit publik dhe atij privat.

Akademia, nga ana e saj, mund të kontribuojë me ekspertizë dhe kërkime të thelluara shkencore për të analizuar dhe zhvilluar metodat më efektive për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe për të mbështetur hartimin e politikave dhe strategjive të mirëfillta antikorrupsion.

Shoqëria civile do të avancojë përmes mekanizmave të rinj të bashkëpunimit, ku Koalicioni Kundër Korrupsionit dhe Rrjeti i Organizatave të Shoqërisë Civile do të institucionalizohen, duke krijuar impakte të qëndrueshme.

Bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat, shoqërisë civile, akademisë, ekspertëve të kërkimit dhe mediave, si grupe interesi me kontribute të rëndësishme dhe burime programore, është kyç për krijimin e një kulture integriteti përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse në shoqëri. Angazhimi dhe ndarja e qartë e përgjegjësive ndërmjet këtyre aktorëve dhe Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit paraqet një mundësi të rëndësishme për përparimin e përpjekjeve kundër korrupsionit, duke siguruar një sinkronizim të veprimtarive dhe kontributit të secilit aktor në mënyrë të harmonizuar dhe të koordinuar. Kjo qasje mund të çojë në rritjen e efektivitetit dhe ndikimit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me objektivin specifik

Objektivi Specifik 3.3 orienton përpjekjet kundër korrupsionit drejt forcimit të bashkëpunimit me shoqërinë civile, sektorin privat, si dhe me akademinë dhe studentët si promotorë të ndryshimit. Ky objektivi synon krijimin e një aleance të fuqishme ku liria e mendimit, forca shtytëse e zhvillimit ekonomik dhe iniciativat krijuese bashkohen për të maksimizuar ndërhyrjet dhe për të arritur rezultate më të mira në luftën kundër korrupsionit. Kjo qasje gjithëpërfshirëse ka për qëllim të krijojë një ndikim të qëndrueshëm dhe të prekshëm në përmirësimin e transparencës dhe integritetit në shoqëri.

Masat do të zbatohen për të arritur këto rezultate:

Rezultati 1: Rritja dhe përfshirja e gjerë shoqërore e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në fuqizimin e transparencës dhe integritetit.

Rezultati 2: Nisma, veprimtari politikash dhe kërkimi mbështetur në hulumtime shkencore dhe ekspertizë të kualifikuar.

Rezultati 3: Rritje e përgjegjësive së institucioneve dhe zyrtarëve publikë mbështetur në bashkëpunime me ekspertizën e pavarur.

Institucione Kryesore: Ministritë e Linjës, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Institucione Kontributore: Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, Organizata të Shoqërisë Civile, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sektori privat, autoritete publike.

Masat dhe aktivitetet

Ky Objektivi Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, ndërkohë që aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneks nr. 1.

	Objektivi Specifik 3.3 Përfshirja e të gjithë shoqërisë, veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit
3.3.1	Masa: Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e sektorit privat në luftën kundër korrupsionit.
3.3.2	Masa: Përfshirja aktive dhe e zgjeruar e organizatave të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit.
3.3.3	Masa: Përfshirja e akademisë në luftën kundër korrupsionit.
3.3.4	Masa: Përfshirja e medias dhe gazetarisë në luftën kundër korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specific dhe dhe institucionet përgjegjëse, me nënkapitullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specific	Institucioni përgjegjës
Rezultati	3.3.1 Përqindja e fushatave të përbashkëta kundër korrupsionit të institucioneve publike me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile, akademinë dhe median, nga mesatarja e regjistruar në tre vitet e fundit (trend rritës).	Përfshirja e gjerë shoqërore, sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në fuqizimin e transparencës dhe integritetit.	3.3 Përfshirja e opinionit publik dhe veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit.	KKKK

Objektivi Specific 3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm

Analiza e situatës dhe sfidat

Aspektet gjinore janë tejet të rëndësishme dhe duhet të integrohen në hartimin dhe programimin e politikave kundër korrupsionit, pasi gratë dhe burrat preken nga korrupsioni në mënyra të ndryshme dhe përjetojnë forma të ndryshme të praktikave dhe sjelljeve korruptive.

Në vitet e fundit, Shqipëria ka arritur nivele të larta të përfaqësimit të grave dhe vajzave, duke ulur ndjeshëm hendekun gjinor dhe pasojat e tij për gjininë më pak të përfaqësuar. Aktualisht, 66% e anëtarëve të Këshillit të Ministrave janë gra, duke treguar një përfaqësim të balancuar në nivelet më të larta të drejtimit. Për më tepër, Shqipëria ka zbatuar një sërë projektesh dhe programesh të përqendruara në qasjen gjinore dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë viteve, janë realizuar një sërë aktivitetsh ndërgjegjësuese për të sensibilizuar opinionin publik dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi ndikimin që korrupsioni ka në jetën e grave. Megjithë përparimet pozitive, ende mungojnë të dhëna të qëndrueshme dhe të detajuara mbi numrin e grave që raportojnë korrupsionin dhe përfshirjen e tyre, qoftë në mënyrë aktive apo pasive, në luftën kundër këtij fenomeni.

Përfshirja e grave në identifikimin dhe luftën kundër korrupsionit përfaqëson një hap të domosdoshëm drejt arritjes së barazisë gjinore. Integrimi i perspektivës gjinore në agjendën antikorrupsion ndërinstitucionale ndihmon në evidentimin e aspekteve të veçanta të korrupsionit që prekin në mënyrë specifike gratë dhe vajzat, ndryshe nga përvoja e pjesës tjetër të shoqërisë. Kjo përfshin forma të ryshfetit, dhunën me bazë gjinore të lidhur me korrupsionin dhe sfida të tjera që shfaqen përmes një lenteje gjinore.

Pjesëmarrja e grave në procesin e identifikimit dhe përparimin e luftës kundër korrupsionit është jetike për thellimin e përpjekjeve në këtë fushë. Ky Objektiv Specific i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 synon të adresojë këtë sfidë, duke njohur dimensionin socio-kulturor të thellë të korrupsionit, përveç atij ligjor, dhe duke nënvizuar rolin e rëndësishëm të grave në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të qëndrueshme.

Kjo qasje krejtësisht e re strategjike synon të rrisë në mënyrë të konsiderueshme vetëdijen mbi ndikimin e korrupsionit tek gratë dhe vajzat. Përfshirja e komponentit gjinor në projektet e mbështetjes së shoqërisë civile do të sigurojë që një pjesë e masave kundër korrupsionit të jenë të drejtuara posaçërisht ndaj nevojave dhe shqetësimeve të grave dhe vajzave, duke i adresuar ato në mënyrë të veçantë.

Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në identifikimin dhe luftimin e korrupsionit ka për qëllim të përmirësojë përfshirjen e tyre në këto përpjekje, të rrisë ndërgjegjësimin publik, të identifikojë aspekte specifike të korrupsionit dhe të forcojë politikën publike. Në të njëjtën kohë, kjo nismë synon të nxisë më tej transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve.

Bashkëpunimi me organizatat që promovojnë barazinë gjinore dhe ndërveprimi me to për matjen e korrupsionit do të ndihmojë në hedhjen dritë mbi natyrën dhe ndikimin specifik të korrupsionit tek gratë dhe vajzat. Prandaj, themeli i kësaj qasjeje qëndron tek parashikimet e bëra në këtë strategji, duke garantuar përfshirjen e perspektivës gjinore në luftën kundër korrupsionit.

Rezultatet e pritshme nga zbatimi i masave që lidhen me objektivin specifik

Objektivi Specifik 3.4 thekson rëndësinë e rolit të grave dhe vajzave në promovimin dhe intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, duke kontribuar gjithashtu në mbledhjen e të dhënave që ndihmojnë në identifikimin e përhapjes dhe prirjeve të këtij fenomeni. Ky objektivi synon të ilustrojë shkallën dhe shtrirjen e formave specifike të korrupsionit, duke përfshirë analizën e llojeve të veçanta të korrupsionit që prekin gratë dhe vajzat, për të ndihmuar në zhvillimin e politikave efektive në këtë fushë.

Masat që do të zbatohen për të arritur këto rezultate:

Rezultati 1: Angazhim dhe përfshirje e organizatave me bazë gjinore me projekte në luftën kundër korrupsionit.

Rezultati 2: Vijim i programit antikorrupsioni nga AMSHC.

Rezultati 3: Dialogim dhe bashkëpunim me perspektivë gjinore në luftën kundër korrupsionit.

Institucione Kryesore: Agjencia për mbështetjen e Shoqërisë Civile, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Institucione Kontributore: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Instituti i Statistikave, Organizata të Shoqërisë Civile.


Masat dhe aktivitetet

Ky Objektivi Specifik do të zbatohet përmes masave të mëposhtme, aktivitetet konkrete për periudhën e parë të zbatimit të SNKK mund të gjenden në Planin e Veprimit 2024-2026, në zbatim të SNKK 2024-2030, Aneksi nr. 1.

	Objektivi Specifik 3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm
3.4.1	Masa: Përfshirja e komponentit gjinor në termat e referencës dhe përcaktimi i një buxheti specifik për projektet e integritetit dhe të antikorrupsionit, të shpallura nga AMSHC.
3.4.2	Masa: Organizimi i aktiviteteve komunikuese dhe ndërgjegjësuere me palë të interesuara me fokus perspektivën gjinore në forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit.

Lidhja e Treguesve kryesorë të rezultateve me Qëllimin e parë të Politikës, Objektivin Specifik dhe dhe institucionet përgjegjëse, me nënkaptullin përkatës të BE-së sipas MSA-së

Lloji i treguesit	Emërtimi i treguesit të performancës	Lidhja me qëllimin e politikës	Lidhja me Objektivin Specifik	Institucioni përgjegjës
Rezultati	3.4.1 Raporti i numrit të projekteve kundër korrupsionit me orientim gjinor në krahasim me numrin tyre në tre vitet e fundit.	Angazhimi i shtuar i grave në pjesëmarrjen politike dhe ekonomike të vendit.	3.4 Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm.	AMSHC



PJESA III


MASAT PRIORITARE TË QEVERISË PËR ZBATIMIN E DOKUMENTIT STRATEGJIK

Në kuadër të zbatimit të tre Qëllimeve të Politikave dhe të Objektivëve Specifikë prioritarë që adresojnë ndërhyrjet posaçërisht të kërkuara për reformën kundër korrupsionit, janë parashikuar këto masa prioritare të qeverisë në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030:

- (Masa 1.2.5)** Hartimi i një kuadri të harmonizuar dhe në koherencë me kuadrin ligjor dhe institucional në luftën kundër korrupsionit dhe integritetit të zyrtarëve publikë dhe funksionarëve politikë (duke reflektuar rekomandimin iii) të Raund V të GRECO për Shqipërinë).
- (Masa 1.3.2- 1.3.8)** Parandalimi i korrupsionit në menaxhimin e sektorëve të pronave/ sistemin shëndetësor dhe kujdesin social/arsimit/ prokurimeve publike/partneritetin publik-privat/ administratën tatimore/sistemin e doganave.
- (Masa 1.6.1)** Forcimi i kuadrit ligjor për sinjalizimin.
- (Masa 1.7.1)** Krijimi i kornizës legjislative dhe institucionale për lobimin.
- (Masa 1.8.1)** Krijimi i kornizës legjislative dhe institucionale për lobimin
- (Masa 2.2.1)** Forcimi i kornizës legjislative për garantimin e një veprimtarive efçente për hetimin e ndëshkimin penal të korrupsionit.
- (Masa 2.2.2)** Forcimi i kornizës institucionale dhe kapaciteteve profesionale të organeve ligjzbatuese dhe stafeve pranë tyre, me fokus hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit.
- (Masa 3.1.1)** Rritja e ndërgjegjësimit dhe komunikimit të vazhdueshëm të qytetarëve për pasojat negative të korrupsionit në shoqëri.
- (Masa 3.2.1)** Forcimi i komponentit të etikës dhe integritetit në kurrikulat në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

PJESA IV

ZBATIMI, LLOGARIDHËNIA DHE KOORDINIMI



Zbatimi koherent, efektiv dhe i suksesshëm i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 synohet të arrihet përmes një qasjeje të përmirësuar zbatimi, nëpërmjet koordinimit ndërinstitucional të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe zbatimit të detyrave funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit. Kjo drejtori është përgjegjëse për koordinimin, hartimin dhe ndjekjen e instrumenteve të nevojshme për zbatimin e politikave antikorrupsion, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 26.06.2024, për ngritjen dhe organizimin e saj. Përtej monitorimit, vlerësimit dhe raportimit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit do të jetë institucioni përgjegjës për zbatimin e plotë të strategjisë, duke përfshirë ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna ndaj institucioneve, implementimin e politikave prioritare, dhe përpilimin e raporteve të monitorimit, të cilat do të vlerësojnë dhe reflektojnë rezultatet e arritura.

Për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe arritjen e rezultateve të synuara, është e nevojshme një largim nga monitorimi tradicional, duke kaluar drejt një qasjeje proaktive. Kjo qasje përfshin planifikimin në kohë dhe realizimin efikas të masave dhe aktiviteteve të tyre (produkteve), të mbikëqyrura nga një zyrë qendrore. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, nën udhëheqjen e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, për shkak të kompetencave, hierarkisë në strukturat kundër korrupsionit dhe përvojës së saj në zbatimin e strategjive të mëparshme, përbën një zgjedhje logjike dhe të përshtatshme për këtë rol.

Për të arritur këtë qëllim, do të përmirësohet koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve me kompetenca kundër korrupsionit (DPAK, ILDKPKI, KDIMDP, KLSH, APP) në zbatimin e Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit dhe politikave të tjera antikorrupsion. Zbatimi i aktiviteteve do të sigurohet përmes hartimit të një plani për periudhën e ardhshme të raportimit, i cili do të përgatitet nga pikat e kontaktit për zbatimin e strategjisë dhe do të miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit.

Për të rritur kapacitetet dhe për të zgjeruar fushën e ekspertizës, është e domosdoshme përfshirja aktive e koordinatorëve kundër korrupsionit, koordinatorëve të integritetit, koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe specialistëve të burimeve njerëzore në institucione. Ata do të ofrojnë mbështetje për pikat e kontaktit kundër korrupsionit në institucionet përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të strategjisë, duke kontribuar aty ku aktivitetet lidhen me fushën e tyre të ekspertizës dhe përgjegjësisë.

Zbatimi efektiv dhe i suksesshëm i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024-2030 synohet të realizohet përmes një sistemi të monitorimit dhe vlerësimit, i cili është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)". Për përgatitjen e Raporteve të Monitorimit, do të ndiqet një proces me disa faza, me qëllim verifikimin e progresit në zbatimin e Objektivave Specifike dhe masave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të miratohet nga Ekipi Tematik Antikorrupsion, në përputhje me parashikimet e urdhrit të Kryeministrit Nr. 90, datë 1.8.2023. Ky proces menaxhohet nga Njësia e Mirëqeverisjes pranë Kryeministrit, e cila vepron si sekretariat teknik për Drejtësinë dhe Demokracinë, dhe nga SASPAC, që shërben si njësia përgjegjëse për koordinimin qendror të Grupeve të Integruara të Menaxhimit të Politikave.

Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) në fushën prioritare “Demokracia, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mire” operon në nivel teknik përmes 8 ekipeve tematike, ku përfshihet edhe Ekipi Tematik për Antikorrupsionin.

Në mbledhjet e ekipeve tematike, do të trajtohen raportet, problematikat dhe pengesat e hasura gjatë zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit (SNKK) dhe funksionimit të aktiviteteve institucionale, të cilat kërkojnë një qasje të përbashkët për zgjidhje. Gjithashtu, do të përcaktohen hapat e mëtejshëm për të siguruar realizimin efektiv të këtyre aktiviteteve.

Një tjetër prioritet do të jetë koordinimi ndërinstitucional në zbatimin e strategjisë. Në këto takime do të marrin pjesë edhe organizata të shoqërisë civile, aktive në fushën e antikorrupsionit, të cilat do të kontribuojnë me mendime dhe vlerësime mbi monitorimin dhe rezultatet e procesit.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit do të përgatisë raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin e progresit në zbatimin e Strategjisë, duke u mbështetur në standardet e përcaktuara nga Metodologjia IPSIS për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike. Këto raporte do të ofrojnë informacion të plotë dhe të përditësuar për politikëbërësit lidhur me ecurinë e zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit të SNKK-së për periudhën e ardhshme 7-vjeçare.


Plani i Veprimit i Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit do të rishikohet çdo tre vjet, me qëllim që të sigurohet një vlerësim i saktë dhe i përgjegjshëm për progresin e realizimit të tij, duke pasur parasysh gjithashtu nivelin e financimit.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë do të mbështetet në një sistem të unifikuar dhe të strukturuar të raportimit të të dhënave nga të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e SNKK-së 2024-2030. Çdo institucion do të raportojë në mënyrë sistematike mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivi dhe mase, mbi burimet buxhetore të alokuara, sfidat e hasura gjatë procesit dhe vlerësimin e përgjithshëm të ecurisë së Strategjisë.

Përpunimi statistikor i të dhënave do të kryhet me anë të shifrimit të përgjigjeve sipas raporteve të marra nga institucionet zbatuese. Këto raporte janë kryesisht të karakterit narrativ, por edhe statistikor, duke raportuar Tregues të Performancës për të matur progresin e zbatimit të masave.

Në përputhje me procedurat që do të ndiqen për raportimin dhe monitorimin e Strategjisë, në zbatim të VKM-së Nr. 290, datë 11.4.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)", procesi i përgatitjes së Raporteve të Monitorimit do të ndjekë fazat e mëposhtme:

- Faza 1** Marrja e kontributeve nga të gjitha institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit.
- Faza 2** Dërgimi i paketës së plotë raportuese për vlerësim pranë SASPAC, në përputhje me standardet e sistemit. Paketa e plotë duhet të përfshijë materialet e mëposhtme:
1. Raportin e konsoliduar për progresin në zbatimin e Strategjisë në përputhje me standardet e sistemit IPSIS.
 2. Planin e zbatueshmërisë së masave për periudhën referuese në përputhje me standardet e sistemit.
 3. Pasaportën e Treguesve në përputhje me standardet e sistemit për periudhën referuese.
- Faza 3** Konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të dërguara nga SASPAC.
- Faza 4** Organizimi i mbledhjes së Ekipit Tematik për Antikorrupsionin.
- Faza 5** Reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit.
- Faza 6** Publikimi i raportit të monitorimit.
- Faza 7** Përcjellja e procedurave (shënimet e takimit dhe konkluzionet operacionale) të mbledhjes së ETA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Njësisë së Mirëqeverisjes në Kryeministri dhe në SASPAC.



PJESA V

PLANI I VEPRIMIT DHE VLERËSIMET FINANCIARE

Plani i detajuar i Veprimit, bashkangjitur si aneks 1 i këtij dokumenti strategjik, është hartuar në përputhje me metodologjinë e sistemit IPSIS. Ai është kostuar dhe buxhetet e detajuara parashikohen në të njëjtën mënyrë në sistemin IPSIS, duke ofruar edhe ndarjen e duhur për programet buxhetore sipas institucioneve.

Në këtë kapitull jepet informacion në lidhje me financimin e Planit të Veprimit, 2024-2026, të SNKK-së, 2024-2030, me qëllim arritjen e tre qëllimeve të politikës dhe objektivave specifike. Për këtë arsye, në këtë pjesë do të jepet informacion mbi alokimin e burimeve financiare për Qëllimet e Politikave, si dhe nevoja financiare që mund të lindë në të ardhmen. Financat do të mbulohen nga buxheti i shtetit, nga donatorët në formën e granteve, kredive ose çdo fondi tjetër kapital apo asistencë teknike të parashikuar. Kostoja totale për zbatimin e Strategjisë parashikohet të jetë lekë. Masat e kostuara në Planin e Veprimit 2024-2026, të cilat janë planifikuar të mbulohen nga fondet e buxhetit të shtetit, janë brenda fondeve të caktuara për institucionet përgjegjëse.

Në vijim, jepet i detajuar financimi, burimet e tij dhe nevojat për financim për secilin nga Qëllimet e Politikës së këtij dokumenti. Në kostimin e masave, objektivave dhe qëllimeve të strategjisë është ndjekur metodologjia e kostimit sipas standardeve IPSIS dhe nuk ka dublikim masash me strategji të tjera kombëtare sektoriale apo ndërsektoriale. Gjatë procesit të detajimit të fondeve janë hasur vështirësi në përcaktimin e plotë dhe të saktë të fondeve të alokuara nga donatorë të ndryshëm për masat specifike të dokumentit strategjik. Duke mbledhur gjithë informacionin specifik mund të merret buxheti i plotë për të realizuar të gjitha politikat e planifikuara.

Si më poshtë, pasyrohet shpërndarja e burimeve të financimit sipas burimeve të financimit për qëllimet e identifikuara në strategji. Gjithashtu për secilin nga qëllimet jepet edhe hendeku financiar dhe nevojat e paplotësuara. Burimet e financimit të hendekut financiar të çdo Qëllimi Politike janë buxheti i shtetit, donatorët nëpërmjet granteve apo edhe fonde të tjera të asistencës teknike.

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit janë institucionet përgjegjëse për koordinimin e veprimeve për të mundësuar realizimin me sukses të masave të parashikuara në strategji.

Hendeku i financimit lidhet me politikat e reja që do ndiqen në lidhje me shtrirjen e qasjeve edhe në sektorë specifikë apo edhe tek biznesi. Ato lidhen me shpenzimet e trajnimit, studim i situatës aktuale apo perceptimit për fenomene të ndryshme, shpërndarje informacioni, platforma online apo faqe web dhe ndryshime strukturash.

Kosto totale e Planit të Veprimit të strategjisë për periudhën 2024 - 2026 është 991.76 milion lekë dhe hendeku financiar është 9.9%. Si vlerë hendeku financiar në total është 98.064 milion lekë.

Nëse analizohet hendeku financiar sipas Qëllimeve të Politikës vihet re se për Qëllimin e parë ai është në vlerën 24.13 milion lekë, për Qëllimin e dytë është në vlerën 55.4 milion lekë dhe për Qëllimin e tretë është në vlerën 18.53 milion lekë.

Identifikimi i shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale bëhet i mundur pas përcaktimit të kuadrit strategjik, sipas qëllimeve, objektivave specifikë dhe masave të strategjisë.

Ky dokument strategjik ka si burim kryesor financimi buxhetin e shtetit me rreth 87.6%. Financimi i dedikuar dhe konfirmuar nga donatorët specifikisht për masat e strategjisë është 2.5%. Donatorët janë Bashkimi Evropian, Banka Botërore, mbështetja e qeverisë zviceriane etj.²²

Duke pasur parasysh këtë përbërje të shpenzimeve totale, mund të thuhet se në koston e secilit nga Qëllimet, peshën më të madhe e zenë shpenzimet për paga dhe ato për shpenzime të tjera korrente.

²² Për arsye të mos detajimit sipas masave, në fondet e mbuluara nga donatorët nuk është përfshirë vlera 3.85 milion euro e mbështetjes teknike nga BE për institucionet e drejtësisë si SPAK, BKH dhe të tjerat, që do fillojë në vitin 2025.

Tabela nr. 1: Kosto sipas Qëllimeve të Politikës (në lekë)

	Paga dhe sigurime shoqërore	Shpenzime korente të tjera	Shpenzime kapitale	Totali
Qëllimi 1- Parandalimi i korrupsionit	638,089,173	215,427,450	0	853,516,623
Qëllimi 2 - Ndëshkimi i korrupsionit	85,606,955	26,566,000	1,380,000	113,552,955
Qëllimi 3 - Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit	2,560,539	20,980,000	1,150,000	24,690,539
Totali	807,653,908	210,073,450	5,290,000	1,023,017,358

Siç vihet re, fokusi është vendosur tek ngritja e infrastrukturës, institucioneve dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore për parandalimin e korrupsionit. Kostot e realizimit të Qëllimit të parë janë ato që zenë peshën më të madhe me 86.1% të kostove totale. Kostot për realizimin e Qëllimit të dytë zenë rreth 11.4% të kostove totale. Ndërkohë kostot e realizimit të Qëllimit të tretë zenë 2.5% të kostove totale.

Tabela e mëposhtme jep alokimin në vite të shpenzimeve totale. Në tabelë vihet re synimi për rritjen e mbështetjes së masave për parandalimin e korrupsionit dhe ndërgjegjësimin dhe edukimin në luftën kundër korrupsionit, e cila reflekton rritje përgjatë viteve të zbatimit të strategjisë.

Tabela nr. 2: Shpërndarja në vite e kostove të parashikuara në planin e veprimit (në lekë)

	2024	2025	2026
Qëllimi 1- Parandalimi i korrupsionit	266,910,307	328,604,188	258,002,128
Qëllimi 2 - Ndëshkimi i korrupsionit	33,727,863	39,975,327	39,849,766
Qëllimi 3 - Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit	4,348,944	3,120,798	17,220,798
Totali	304,987,114	371,700,312	315,072,691

Përsa i përket burimit të financimit, buxheti i shtetit mbulon përqindjen më të madhe të shpenzimeve. Informacioni për secilin nga qëllimet e politikës jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3: Burimi i financimit (në lekë)

	Buxheti i Shtetit	Donatorë	Hendek
Qëllimi 1- Parandalimi i korrupsionit	813,581,055	15,806,000	-24,129,568
Qëllimi 2 - Ndëshkimi i korrupsionit	52,478,102	5,670,000	-55,404,854
Qëllimi 3 - Ndërgjegjësimi dhe edukimi në luftën kundër korrupsionit	2,560,538	3,600,000	-18,530,001
Totali	868,619,695	25,076,000	-98,064,423

Në këtë dokument strategjik janë përcaktuar 9 objektiva të politikës në Qëllimin e parë, 3 objektiva të politikës për Qëllimin e dytë dhe 4 objektiva të politikës për Qëllimin e tretë. Ndër këta objektiva, Objektivi 1.2: Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes, zë peshën më të madhe në koston totale të strategjisë me 78.5% të koston totale dhe Objektivi 2.2: Forcimi i kapaciteteve, burimeve dhe performancës për hetim penal efektiv dhe ndjekjen penale të korrupsionit, zë 9.7% të koston totale.

Ndërkohë objektivat që zënë peshën më të vogël janë Objektivi specifik 3.4: Forcimi i pjesëmarrjes së grave për të identifikuar dhe luftuar korrupsionin në nivele dhe sektorë të ndryshëm me 0.16% dhe Objektivi specifik 3.3: Përfshirja e sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë me rol ndërgjegjësues luftën kundër korrupsionit me një peshë në koston totale prej 0.11%.



PJESA VI

PASAPORTA E

TREGUESVE

Treguesit e monitorimit të dokumentit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit, 2024-2030

Treguesit e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale Kundër Korrupsionit (SNKK) do të bazohen në një sërë treguesish kryesorë të performancës, të lidhur me qëllimet e politikës dhe objektivat specifike të Planit të Veprimit, siç janë pasqyruar në këtë dokument.

Progresi i zbatimit të SNKK-së do të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë periodike duke matur këta tregues, të cilët janë vendosur në përputhje me qëllimet dhe objektivat e politikës përkatëse. Gjithashtu, vlerat e synuara (targetet) mund të rishikohen nga Ekipi Tematik për Antikorrupsionin, me qëllim arritjen e tyre në mënyrë më efektive.

Pasaporta e Treguesve të Performancës, e cila përfshin tre qëllimet e politikës së SNKK-së, së bashku me përshkrimin e metodologjisë përkatëse dhe vlerat e synuara, janë paraqitur në Aneksin 2 të bashkëlidhur me këtë dokument.